

# AVANCIMI I TË DREJTAVE LGBTI DUKE NDËRTUAR KAPACITETET E NËNPUNËSVE PUBLIK:

Një vlerësim i programeve të trajnimit  
të institucioneve publike në Kosovë

Mars 2018



## Mirënjohje

Organizatave anëtare të Koalicionit dëshirojnë të falënderojnë të gjithë të intervistuarit nga institucionet dhe organizatat e ndryshme për gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë dhe të ofrojnë informacione dhe të dhëna të vlefshme për këtë raport.

## OJQ-të që udhëhoqën publikimin e raportit

### CEL Kosova

Qendra për Barazi dhe Liri të pjesëtarëve të komunitetit LGBT në Kosovë (CEL) është themeluar në korrik të vitit 2013, me qëllim të fuqizimit të **komunitetit LGBT** në Kosovë, të parandalimit të diskriminimit në bazë të orientimit seksual, të rritjes së ndërgjegjësimit të popullsisë mbi të drejtat e pjesëtarëve të komunitetit LGBT dhe me qëllim të avokimit për të drejtat e barabarta dhe jo-diskriminimit të pjesëtarëve të komunitetit LGBT në Kosovë, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. CEL gjithashtu synon të forcojë kuadrin ligjor në vend me efekt dhe ndikim tek pjesëtarët e komunitetit LGBT, si dhe të rris nivelin e pjesëmarrjes aktive të pjesëtarëve të komunitetit LGBT në Kosovë në mekanizmat përkatës ndërkombëtarë dhe rajonalë dhe në projekte të dobishme për pjesëtarët e komunitetit dhe shoqërinë në përgjithësi.

### CSGD

Qendra për zhvillimin e grupeve shoqërore (QZhGSh) është një organizatë jo-qeveritare që mbron dhe promovon të drejtat e **komunitetit LGBT** në Kosovë. Fokusi kryesor i QZhGSh-së është në: (1) Fuqizimin e komunitetit LGBT; (2) Avokimi dhe lobimi për të drejtat e njeriut të pjesëtarëve të komunitetit LGBT; dhe (3) rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë në lidhje me çështjet me të cilat përballen pjesëtarët e komunitetit LGBT.

## Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë

ERAC bashkon shtatë (7) OJQ që punojnë në fushën e sundimit të ligjit dhe të drejtave themelore në bashkëpunim të ngushtë me nëntëmbëdhjetë (19) OJQ të angazhuara kryesisht në nivel lokal, me një fokus të veçantë në krijimin e një rrjeti të qëndrueshëm të OJQ-ve që janë aktive në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të grupeve të rrezikuara dhe/ose të marginalizuara (GRM-ve). Fokus specifik i projektit janë grupet si në vijim: **të gjitha komunitetet jo-shumicë në Kosovë, gratë, të rinjtë dhe pjesëtarët e komunitetit LGBT**. Edhe pse punojnë apo shtrijnë veprimet e tyre në tema dhe çështje të ngjashme, këtyre OJQ-ve u mungon bashkëpunimi dhe shpesh përqendrimi i punës së tyre është i ndarë në bazë të grupeve të veçanta të synuara, me të cilat punojnë ato, apo i ndarë sipas rajoneve ku ato shtrijnë aktivitetet e tyre. Me krijimin e një bashkëpunimi strukturor në mes të OJQ-ve të përzgjedhura dhe me ofrimin e mundësive formale për mësim të vazhdueshëm, veprimi gjeneron shkëmbimin e njohurive dhe përvojës në mes të OJQ-ve (duke përfshirë përvojën në çështjet institucionale), për të forcuar kapacitetet e tyre për avokim me institucionet qendrore dhe komunale, dhe për të rritur dukshmërinë e tyre në terren.

Anëtarët e ERAC janë organizatat e mëposhtme:

- Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë;
- Qendra për Zhvillimin e Grupit Social;
- Qendra për Barazi dhe Liri për Komunitetin LGBT në Kosovë;
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore;
- Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut;
- Kosova Glocal;
- Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal.

## Klauzolë e përgjegjësisë

Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e ECMI Kosovo dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

## E drejta autoriale

© Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë - ERAC, mars 2018. Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdo lloj mjete, elektronik, mekanik, foto-kopjimi, incizimi ose ndryshe, pa lejen paraprake të ERAC.



# **AVANCIMI I TË DREJTAVE LGBTI DUKE NDËRTUAR KAPACITETET E NËNPUNËSVE PUBLIK:**

Një vlerësim i programeve të trajnimit të institucioneve publike në Kosovë



SHKURTESAT.....	6
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	7
PREZANTIMI.....	8
METODOLOGJIA.....	9
<b>1 MEKANIZMAT PËR TË DREJTAT E NJERIUT.....</b>	<b>10</b>
1.1 Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues.....	10
1.2 Grupi Koordinues Ndërmintor për të Drejtat e Njeriut(GKNMDNJ).....	12
1.3 Drejtat e njeriut/ mbrojtja kundër njësive të diskriminimit/ zyrtarët në nivel të komunës dhe ministrive.....	12
1.4 Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP).....	18
<b>2 ADMINISTRATA.....</b>	<b>19</b>
2.1 Divizioni i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Kapaciteteve, Ministria e Administratës Publike.....	19
2.2 Departamenti për Performancë dhe Transparencë Komunale, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).....	19
2.3 Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP).....	19
<b>3 ARSIMI.....</b>	<b>21</b>
<b>4 KUJDESI SHËNDETËSOR.....</b>	<b>22</b>
<b>5 ZBATUESIT E LIGJIT.....</b>	<b>23</b>
5.1 Prokuroria dhe gjyqësori.....	23
5.1.1 Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK).....	23
5.1.2 Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK).....	24
5.1.3 Akademia e Drejtësisë (AD).....	24
5.2 Policia e Kosovës (PK).....	25
5.2.1 Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP).....	26
<b>KONKLUDIMET.....</b>	<b>27</b>
<b>REKOMANDIMET.....</b>	<b>28</b>
<b>ANEKS I - Pyetësor për institucionet e Kosovës.....</b>	<b>29</b>
<b>ANEKS II – Rekomandimet nga Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues për të Drejtat e Komunitetit LGBT në Kosovë.....</b>	<b>36</b>

## SHKURTESAT

<b>LGBTI</b>	Lezbike, Gej, Biseksual, Transgjinator, Interseks
<b>NDI</b>	Instituti Kombëtar Demokratik
<b>ZQM</b>	Zyra për Qeverisje të Mirë (Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mosdiskriminim)
<b>GKK</b>	Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues për të drejtat e LGBT
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>GKMNDNJ</b>	Grupi Koordinues Ndërmintor për të Drejtat e Njeriut
<b>IKAP</b>	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
<b>KPK</b>	Këshilli Prokurorial i Kosovës
<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<b>IAP</b>	Institucioni i Avokatit të Popullit
<b>AD</b>	Akademia e Drejtësisë
<b>PK</b>	Policia e Kosovës
<b>AKSP</b>	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
<b>PKMSA</b>	Programi Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit
<b>MAPL</b>	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
<b>MEST</b>	Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë

## PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Mbrojtja e avancuar ligjore e të drejtave të njeriut shpesh nuk kthehet në praktikë. Ky vlen veçanërisht në rastet për komunitetet në nevojë të cilët, përveç që kanë të bëjnë me këtë mungesë sundimi të ligjit, përballen me refuzim shoqëror. Duke buruar nga vlerat tradicionale të shoqërisë, stigma e lidhur me komunitetin LGBTI është parë në refuzimin e të drejtave, diskriminim dhe dhunë. Kjo është e dukshme edhe në mesin e nëpunësve civil, pavarësisht nga ndeshja me detyrimet e tyre profesionale.

Pasi që kjo është një pengesë e madhe për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave LGBTI, ky raport shqyrton dhe vlerëson cilësinë e programeve ekzistuese të trajnimit për të drejtat dhe çështjet LGBTI në të cilat marrin pjesë nëpunësit publik. Poashtu shqyrton nivelin e suksesit të arritur nga Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues për të drejtat LGBTI brenda institucioneve përkatëse, në aspektin e ofrimit të trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve të nëpunësve publik mbi të drejtat dhe çështjet LGBTI, me qëllimin e avancimit të mbrojtjes dhe promovimit të tyre.

Ky raport konfirmon që deri vonë, institucionet e Kosovës nuk kanë treguar asnjë përpjekje për përmirësimin e njohurive të nëpunësve publik mbi të drejtat e garantuara LGBTI në Kosovë, gjë që do të ndihmonte në luftimin e diskriminimit dhe mohimin e të drejtave LGBTI nga nëpunësit publik. Ishte projekti i binjakëzimit "Lufta kundër Homofobisë dhe Transfobisë" i Bashkimit Evropian, që inicioi një sërë trajnimesh për një numër të institucioneve publike nga fushat përkatëse dhe trajnoi një numër të trajnerëve për barazi, megjithëse programi i trajnimit nuk duket i qëndrueshëm. Kjo është për shkak të mungesës së mbështetjes financiare të trajnuesve për barazi nga institucionet e tyre dhe mungesës së interesimit nga kolegët e tyre mbi këtë temë.

Gjithashtu, ky raport tregon se pothuajse asnjë institucion nuk ka ndjekur rekomandimet e Grupit Këshillëdhënës dhe Koordinues për të drejtat LGBTI. Janë finalizuar vetëm rekomandimi për përfshirjen e çështjeve të barazisë dhe çështjeve LGBTI si ndërsektoriale në kurrikulën e arsimit publik të Kosovës dhe rekomandimi për përfshirjen e trajnimit për të drejtat e njeriut në programin e Institutit të Kosovës për Administratë Publike të iniciuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë.

Në përgjithësi, ky raport mbështet nevojën për trajnim mbi të drejtat dhe çështjet LGBTI për nëpunësit publik si hap i domosdoshëm për të përmirësuar mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave LGBTI, pasi tregon stigmën e madhe dhe refuzimin e komunitetit LGBTI mes nëpunësve publik, veçanërisht atyre në rolet e avokatëve dhe zbatuesve të të drejtave të njeriut.

Kosova siguron një mbrojtje të avancuar ligjore për të drejtat e njeriut që përputhet me standardet ndërkombëtare. Parimet e barazisë dhe mos diskriminimit janë të ngulitura në themelet e kushtetutës së saj. Korniza ligjore e Kosovës mbron fusha të ndryshme të jetës publike dhe private, dhe rregullon mekanizma përkatës për zbatimin e saj. Megjithatë, sfida kryesore e shtetit mbetet në realizimin e këtyre garancive për të drejtat e njeriut.

Sundimi i ligjit është pengesë e zakonshme për Kosovën, madje edhe më shumë kur bëhet fjalë për mbrojtjen e komuniteteve të marginalizuara, veçanërisht të komunitetit LGBTI. Kjo është veçanërisht për shkak të vlerave tradicionale të shoqërisë dhe stigmës së lartë shoqërore të lidhur me komunitetin LGBTI, që shtrihet drejtpërdrejtë tek nëpunësit publik dhe zbatuesit e ligjit. Në të vërtetë, ekziston një nivel i lartë imospërfilljes nga nëpunësit publikë lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e drejtave LGBTI. Në rastet më të këqia që përfshijnë nëpunësit publik, janë rastet ku ata i shkelin të drejtat LGBTI. Përkatësisht, në një studim të kryer nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) mbi komunitetin LGBTI në Kosovë, janë raportuar abuzime psikologjike (12%) dhe dhunë fizike (17%) të kryera nga zyrtarët në institucione dhe organizata. Ngjajshëm, studimi tregon se komuniteti LGBTI në Kosovë ka raportuar diskriminim në arsim dhe zhvillim personal (24%), 14% në mbrojtje nga policia, dhe 10% në qasje në shërbimet publike.<sup>1</sup>

Përveç kësaj, mungesa e njohurive mbi çështjet LGBTI dhe drejtat përkatëse të garantuara nga ligji, paraqet pengesë tek nëpunësit publikë për mbushjen e mandatit të tyre dhe detyrimeve konkrete për komunitetin LGBTI. Gjetjet nga studimi më parshëm tregojnë që në përgjithësi ka ndërgjegjësim të ulët në mesin e nëpunësve publikë për çështjet konkrete që kanë të bëjnë me komunitetin LGBTI<sup>2</sup>. Sistemi arsimor vazhdon të përhap intolerancë dhe refuzim kryesisht duke e shikuar të qenurit LGBTI si sjellje devijante apo sëmundje mendore, dhe kështu duke e ngulitur këtë tregues në diskursin publik.<sup>3</sup>

Ky raport hulumton ekzistencën e programeve të trajnimit për nëpunësit publikë lidhje me të drejtat dhe çështjet LGBTI dhe vlerëson cilësinë e tyre. Në të njëjtën kohë, raporti shqyrton zbatimin e rekomandimeve të Grupit Këshillëdhënës dhe Koordinues (GKK), të lidhura kryesisht me ofrimin e trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve të nëpunësve publikë mbi të drejtat dhe çështjet LGBTI për avancimin e mbrojtjes dhe promovimit të tyre. Raporti fillon me një shpjegim rreth metodologjisë së përdorur, dhe vazhdon me shqyrtimin e secilit institucion përkatës që është në pozitë të ofrojë trajnime dhe të ndërtojë kapacitetet e nëpunësve publikë (shumica e tyre janë adresuar nga rekomandimet e GKK-së), si dhe ato që lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave LGBTI. Pas analizës së studimit që mbulon mekanizmat e të drejtave të njeriut, administratën, arsimin, kujdesin shëndetësor dhe zbatuesit e ligjit, është dhënë një konkludim dhe janë propozuar një grup i rekomandimeve konkrete.

<sup>1</sup> Instituti Kombëtar Demokratik, LGBTI Sondazhi i Opinioneve Publike – Ballkani Perëndimor (Instituti Kombëtar Demokratik, 2015), në dispozicion në: <https://www.slideshare.net/NDIdemocracy/ndi-public-opinion-poll-in-the-balkans-on-lgbti-communities>.

<sup>2</sup> Nisma e të Rinjëve për të drejtat e Njeriut – Kosovë dhe Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, Liria dhe Mbrojtja për Lesbiket, Homoseksualët, Bisexualët dhe Transgjinerorët në Kosovë (Prishtina: Nisma e të Rinjëve për të drejtat e Njeriut – Kosovë, 2013), në dispozicion në: [http://ks.yihr.org/public/fck\\_files/ksfile/LGBT%20report/Freedom%20and%20Protection%20for%20LGBT%20in%20Kosovo.pdf](http://ks.yihr.org/public/fck_files/ksfile/LGBT%20report/Freedom%20and%20Protection%20for%20LGBT%20in%20Kosovo.pdf).

<sup>3</sup> Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore – CSGD dhe Qendra për Barazi dhe Liri – CEL, Reflektim mbi të drejtat LGBTI në Kosovë: Raporti Vjetor 2016, (Prishtina, Kosovë Nëntor 2016), në dispozicion në: <http://csgd-ks.org/wp-content/uploads/2017/02/Annual-Report-ENG.pdf>.



## **METODOLOGJIA**

Ky raport bazohet në studimin primar dhe sekondar. Studimi sekondar parapriu atë primar, dhe përfshiu rishikimin e kornizës ligjore dhe raportet e institucioneve dhe organizatave përkatëse. Ndërsa studimi primar përbëhej nga (1) një pyetësor i dizajnuar të mbledhë informata të detajuara në lidhje me programet e trajnimit të institucioneve të mandatuara për të ofruar trajnime përkatëse për nëpunësit publikpër mbrojtje dhe promovim të të drejtave LGBTI (aneks I) dhe (2) pyetje shtesë të hartuara posaçërisht për të vlerësuar zbatimin e "Rekomandimeve për Mbrojtjen dhe Përfshirjen e Qëndrueshmërisë së Trajnimit të Ndërgjegjësimit për Barazinë dhe të Drejtat e Komunitetit LGBT në Institucionet Publike të Kosovës" lëshuar nga Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues për të Drejtat LGBT (shtojca II), pasi shumica e rekomandimeve kanë të bëjnë me ofrimin e trajnimeve.

Pyetësori është dërguar tek institucionet në mënyrë elektronike si kërkesë për qasje në dokumentet publike bazuar në dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike. Pyetjet shtesë i janë dërguar edhe institucioneve të cilët kanë adresuar rekomandimet nga GKK. Megjithëse jo të gjitha këto institucioneu janë përgjigjur kërkesave përkundër detyrimit ligjor, informacionii marrë ka qenë i mjaftueshëm për të përshkruar numrin e trajnimeve për të drejtat LGBTI të ofruara për nëpunësit publik dhe fushëveprimin e tyre. Informacioni është analizuar në kuadër të mandatit të secilit institucion.

# 1. MEKANIZMAT PËR TË DREJTAT E NJERIUT

## 1.1 Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues

Krahas sigurimit të mbrojtjessë avancuar ligjore për të drejtat e njeriut, korniza ligjore e Kosovës i ka dhënë pëparësi çështjeve të të drejtave të njeriut duke integruar një numër të mekanizmave për të drejtat e njeriut në krye të strukturës si dhe në të gjitha nivelet e saj. Mekanizmi më i lartë qeveritar i themeluar në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë, Drejtatë Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mosdiskriminim (Zyra për Qeverisje të Mirë - ZQM) është krijuar për t'i ofruar Qeverisë së Kosovës këshilla dhe të hartojë politika në fushat e qeverisjes së mirë, drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit<sup>4</sup>. ZQM gjithashtu është mandatuar me përgjegjësi mbikëqyrëse dhe këshilluese për të gjitha ministrinë në çështjetë ngjashme. Përveç kësaj, në Dhjetor të vitit 2013 në kuadër të mandatit të ZQM, Qeveria e Kosovës themeloi **Grupin Këshillëdhënës dhe Koordinues** për të drejtat LGBT<sup>5</sup> si një akt angazhimi për avancimin e pozitës së komunitetit LGBTI në Kosovë. Për pasojë, si themelues dhe udhëheqës i GKK-së, mandati i ZQM-së përfshin përgjegjësi të drejtpërdrejta për promovimin e të drejtave LGBTI dhe avancimin e mbrojtjes së tyre përmes partneritetit të rregullt dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve vendore dhe ndërkombëtare dhe organizatave joqeveritare (OJQ) të angazhuara në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave LGBTI<sup>6</sup>.

Puna e GKK-së është mbështetur nga një projektbinjakëzimi dy vjeçar i Bashkimit Evropian **"Lufta kundër Homofobisë dhe Transfobisë"** e udhëhequr nga instituti Austriak Ludwig Boltzmann për drejta të njeriut, dhe i mbështetur nga Instituti Kombëtar Finlandez për shëndetësi dhe mirëqenie. Projekti ka për qëllim të luftojë homofobinë dhe transfobinë në mesin e publikut dhe brenda institucioneve të shtetit përmes ndërtimit të kapaciteteve të autoriteteve të Kosovës. Për të arritur këtë, ekspertët e projektit ofruan trajnime për trajnerët dhe një sërë trajnimesh mbështetëse për nëpunësit publik. Sipas raportit të projektit të binjakëzimit të BE-së i vënë në dispozicion nga ZQM<sup>7</sup>, një grup i nëpunësve publik (17 pjesëmarrës) të identifikuar dhe përzgjedhur nga anëtarët e GKK-së janë trajnuar si trajnues për barazi me fokus të veçantë në të drejtat dhe çështjet LGBTI prej 03 deri më 05 Nëntor 2014. Më vonë, prej 17 deri më 19 mars 2015, të njëjtit grup (16 pjesëmarrës) ju është ofruar një trajnimmbi aftësitëe trajnuesit. Përfundimisht, 15 zyrtarë, z. Arian Mustafa, znj. Fatime Jasiqi, znj. Habibe Buzuku dhe znj. Leonora Shala (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë), znj. Sanie Kiçmari (Ministria e Shëndetësisë), znj. Teuta Fazliu (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal), znj. Nezaqete Rukovci (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit), znj. Keriman Sadikaj (ZQM), z. Bajrush Rexhepi, z. Esat Marovca, z. Fadil Gashi dhe z. Vesel Gashi (Policia e Kosovës), znj. Biljana Rexhiq dhe znj. Mejreme Zekaj (Këshilli Gjyqësor i Kosovës) dhe z. Sylejman Sopa (Këshilli Prokurorial i Kosovës) janë certifikuar si trajnues për barazi me 25 tetor 2015. Fatkeqësisht, siç është theksuar në raportin e ZQM, shumica e trajnuesve të certifikuar ndjehen të shqetësuar për aftësitë e tyre për të arritur sukses në organizimin e trajnimeve për kolegët e tyre pasi nuk ishin të sigurtë që institucionet e tyre do të ishin në gjendje dhe të gatshme t'i mbështesin ata në këtë detyrë.

<sup>4</sup> Rregullore Nr.16/2013 për Strukturën Organizativetë Zyrës së Kryeministrit, neni 40, (2013).

<sup>5</sup> Vendimi Nr. 05/161, 2013.

<sup>6</sup> Ibid.

<sup>7</sup> Sadete Demaj, "RE: Kerkese per qasje ne dokumente publike" [RE: Request for access to public documents], Email to CSGD, 31 October 2017.

Pavarësisht pengesave, projekti i binjakëzimit i BE-së gjithashtu mbështeti trajnimet ndër kolegë. Kështu, me 28 gusht, 30 shtator, 13 dhe 14 tetor 2015 u mbajtën katër trajnime për zyrtarë në ministri dhe komuna (48 pjesëmarrës); me 10, 11, 28 dhe 29 shtator 2015 u mbajtën katër trajnime për mësues dhe trajnerët e mësuesve (41 pjesëmarrës) nga mbarë Kosova; në pesë regjione të Kosovës – Mitrovicë, Ferizaj, Prizren, Pejë dhe Gjilan u mbajtën pesë seanca trajnimi me policë; dy trajnime janë mbajtur për gjyqësor (24 pjesëmarrës) me 09 dhe 10 korrik dhe 07 – 08 tetor 2015.<sup>8</sup>

Përveç kësaj, projekti i binjakëzimit i BE-së ofroi një numër të trajnimeve të specializuara: një trajnim dy ditor për administratën publike (katër pjesëmarrës) në dhjetor 2016; një trajnim dy ditor për gjyqësorin në janar 2015; një trajnim një ditor për policinë në shkurt 2015; një trajnim pesë ditor për zyrtarët e arsimit në dhjetor 2015; dy trajnime një ditore për prokurorët (8 pjesëmarrës) në dhjetor 2015; dhe një trajnim një ditor me 29 zyrtarë ligjor të Institucionit të Avokatit të Popullit mbi rastet me ekspertë të paanshëm (*amicus curiae*).<sup>9</sup>

Informacioni për përmbajtjen e programeve të trajnimit nuk ofrohet nga projekti i binjakëzimit i BE-së dhe as nuk është dhënë kur është kërkuar nga ZQM.<sup>10</sup> Megjithatë, ekziston një pakënaqësi me kompetencën e trajnerëve për barazi në lidhje me të drejtat dhe çështjet LGBTI, dhe një shqetësim rreth probabilitetit të shpërndarjes joadekuate të informacionit nëpërmjet trajnimeve të ardhshme ndër kolegë.<sup>11</sup>

Pas shqyrtimit të situatës së komunitetit LGBTI, dhe fushat ku kërkohet ndërhyrje, GKK ka përpiluar dhe prezantuar një numër të rekomandimeve<sup>12</sup> për institucionet në "Konferencën e përbashkët për mbrojtjen e përfshirjes së trajnimit të ndërgjegjësimit mbi të drejtat LGBTI në institucionet publike të Kosovës" të organizuar me 16 mars 2016. Në konferencë morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë të institucioneve të cilëve u janë dhënë rekomandimet, dhe të cilët konfirmuan angazhimin e institucioneve të tyre në zbatimin e rekomandimeve përkatëse.<sup>13</sup> Rekomandimet e njëjta u janë dërguar në mënyrë elektronike pjesëmarrësve të konferencës nga ZQM<sup>14</sup>, të cilët nuk kanë aplikuar monitorim sistematik në të njëjtin nivel të përfaqësimit institucional siç kërkon mandati<sup>15</sup>, megjithatë, monitorimi është bërë përmes raportimit të anëtarëve të GKK-së<sup>16</sup>. Kjo nënkupton një mungesë në punën e ZQM-së dhe rezultate të kufizuara të punës së GKK-së në koordinim dhe platformë të shkëmbimit të informacionit, por jo edhe në veprime konkrete dhe ndryshim thelbësor të politikave.<sup>17</sup>

<sup>8</sup> Sadete Demaj, "RE: Kerkese per qasje ne dokumente publike" [RE: Request for access to public documents], Email CSGD-së, 31 Tetor 2017.

<sup>9</sup> Ibid.

<sup>10</sup> CSGD, "RE: Kerkese plotesuese per qasje ne dokumente publike" [RE: Additional request for access to public documents], Email Sadete Demaj, 07 Nëntor 2017.

<sup>11</sup> Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore – CSGD dhe Qendra për Barazi dhe Liri – CEL, Raporti Vjetor 2016: Reflektimi mbi të drejtat e LGBTI në Kosovë, (Prishtina, Kosovë Nëntor 2016).

<sup>12</sup> Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit–Zyra për Qeverisje të mirë, "Rekomandime për Mbrojtjen dhe Përfshirjen e Qëndrueshmërisë së Trajnimit të Ndërgjegjësimit për Barazinë dhe të Drejtat e Komunitetit LGBT në Institucionet Publike të Kosovës" in Konferencën e përbashkët për mbrojtjen e përfshirjes së trajnimit të ndërgjegjësimit mbi të drejtat e LGBTI në institucionet publike të Kosovës (Prishtina, Kosovë, 2016).

<sup>13</sup> Procesverbali nga "Konferencën e përbashkët për mbrojtjen e përfshirjes së trajnimit të ndërgjegjësimit mbi të drejtat e LGBTI në institucionet publike të Kosovës" 16 Mars 2016.

<sup>14</sup> Sadete Demaj, "Procesverbali/Minutes", Email-ipjesëmarrësve të konferencës, 10 Maj 2016.

<sup>15</sup> Regulation No.16/2013 on the Organizational Structure of the Office of the Prime Minister, article 40/1.2, (2013).

<sup>16</sup> Sadete Demaj, "RE: Kerkese per qasje ne dokumente publike" [RE: Request for access to public documents], Email CSGD-së, 27 Tetor 2017.

<sup>17</sup> Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore - CSGD, "Rishikimi: Komuniteti LGBTI dhe të drejtat e tyre në Kosovë–Raporti Vjetor 2017", (Prishtina, Kosovë).

Përfundimisht, përtej angazhimit të tyre në kuadër të GKK-së dhe trajnimeve të mbajtura në kuadër të projektit të binjakëzimit të BE-së, ZQM nuk ka raportuar të ketë filluar apo zbatuar ndonjë trajnim shtesë për të drejtat dhe çështjet LGBTI.<sup>1819</sup>

## 1.2 Grupi Koordinues Ndërministror për të Drejtat e Njeriut (GKNMDNJ)

Me qëllim të përmirësimit të koordinimit institucional të nivelit të lartë dhe zbatimit të strategjive dhe politikave për të drejtat e njeriut, Qeveria e Kosovës ka themeluar Grupin Koordinues Ndërministror për të Drejtat e Njeriut në maj të vitit 2016. Grupit, i përbërë nga ministrat e një linje emistrive, avokatit të popullit dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, i janë caktuar detyrat: forcimi i koordinimit ndërmjet të gjitha ministrive dhe autoriteteve kompetente në qeveri në fushën e drejtave të njeriut; monitorimi i zbatimit të të gjitha politikave dhe strategjive të të drejtave të njeriut në Kosovë; shkëmbimin e informacioneve dhe të dhënave mbi zbatimin e rekomandimeve të përfshira në raportet e komisioneve dhe organeve tjera të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës, Bashkimit Evropian dhe organizata tjera ndërkombëtare; buxheti dhe krijimi i politikave prioritare për të drejtat e njeriut; të bëjë propozime për avancimin e kuadrit ligjor në fushën e të drejtave të njeriut dhe propozime të tjera të rëndësishme për përmirësimin e të drejtave të njeriut në Kosovë.<sup>20</sup>

Megjithëse grupi nuk është i mandatuar të ofrojë trajnime, përgjegjësitë e tij, si monitorimi i rekomandimeve, strategjive dhe politikave për të drejtat e njeriut, buxheti dhe krijimi i politikave prioritare për të drejtat e njeriut janë të lidhura ngushtë me avancimin e të drejtave LGBTI nëpërmjet programeve të trajnimit dhe veçanërisht me zbatimin e rekomandimeve të GKK-së. Megjithatë, pasi që GKNMDNJ nuk ka mbajtur asnjë takim tjetër që nga themelimi më 20 shkurt 2017, nuk mund të bëhet asnjë vlerësim tjetër i ndikimit të tyre në lidhje me fushën e këtij raporti, përveç të nënkuptohet mosfunksionimi i tyre.

## 1.3 Drejtat e njeriut/ mbrojtja kundër njësive të diskriminimit/ zyrtarët në nivel të komunës dhe ministrive

Ligji anti-diskriminim i miratuar në 2015<sup>21</sup> solli një ndryshim të vogël në strukturën ekzistuese në qeveri për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Nga njëra anë, ligji shfuqizoi veprimin i cili krijoi njësitë në ministri për drejtat e njeriut<sup>22</sup>, ndërsa nga ana tjetër solli një rregullore<sup>23</sup> që detyron ministrinë të ricaktojnë njësitë apo zyrtarët për mbrojtje nga diskriminimi. Në fakt, kjo ju ofron këtyre njësive/zyrtarëve një gamë të gjerë të detyrave dhe përgjegjësi që synojnë luftimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë<sup>24</sup>. Ngjashëm, kjo rregullore ndikon tek komunat duke i detyruar ato të emërojnë njësi apo zyrtarë për mbrojtje nga diskriminimi, të cilëve njëjtë si homologëvetë tyre në nivel të ministrisë, u janë caktuar përgjegjësi mjaft të gjera për luftimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë<sup>25</sup>. Megjithatë, ky ndryshim ligjor nuk u pasua nga ri-sistematizimi i personelit, gjë që nënkupton që personat të cilët mbajnë pozitën e zyrtarëve për të drejtat e njeriut apo ndonjë pozitë të ngjashme u janë dhënë përgjegjësi të tilla të reja. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për t'u theksuar, pasi që studimet kanë treguar se zyrtarët e të drejtave të njeriut kanë pasur

<sup>18</sup> Sadete Demaj, "RE: Kerkese per qasje ne dokumente publike" [RE: Request for access to public documents], Email CSGD-së, 27 Tetor 2017.

<sup>19</sup> Sadete Demaj, "RE: Kerkese per qasje ne dokumente publike" [RE: Request for access to public documents], Email CSGD-së, 31 Tetor 2017.

<sup>20</sup> Decision No. 06/87, 2016.

<sup>21</sup> Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2015.

<sup>22</sup> Udhëzimi Administrativ No. 2011/04 për Njësitë për të Drejtat e Njeriut në Qeverinë e Kosovës, 2007.

<sup>23</sup> Rregullorja Nr. 03/2017 për Mekanizmat Institucional mbi Mbrojtjen kundër Diskriminimit në Qeveri dhe Komuna, 2017.

<sup>24</sup> Ibid, artikulli 9.

<sup>25</sup> Ibid, artikulli 10.

ekspozim të kufizuar ndaj çështjeve LGBTI dhe vetëm pak prej tyre kanë marrë trajnim<sup>26</sup>. Për më tepër, përveç njohurive të tyre të kufizuara rreth çështjeve LGBTI, disa prej tyre kanë treguar rezistencë haptazindaj të drejtaveLGBTI<sup>27</sup>.

Përgjigjet e dhëna nga njësitë/zyrtarët për diskriminim në pyetësorin mbi mundësinë e trajnimit për ata që punojnë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut për të drejtat LGBTI tregojnë se asnjë nga këto njësi/zyrtarë nuk ka kryer trajnime të tilla. Disa përgjigje kanë nxjerrë në pah pengesat e krijuara nga kufizimet financiare përderisa të tjerat kanë theksuar mungesën e mundësive që kishin zyrtarët e të drejtave të njeriut për këto trajnime. Kjo e fundit nënkupton ndërgjegjësimin për mungesën e njohurive mbi të drejtat dhe çështjet LGBTI, dhe gjithashtu tregojnë mentalitetin e tyre që trajnimet duhet të jenë vetëm për zyrtarë. Kjo për shkak të mungesës së kuptimit të qartë të rolit të tyre në promovimin e të drejtaveLGBTI, qoftë edhe përmes trajnimeve, gjithashtu edhe fuqia e tyre e kufizuar brenda institucioneve të tyre për të ndërmarrë iniciativa të tilla. Përgjigjet më tej tregojnë mos pranimin e komunitetit LGBTI nga zyrtarët publik deri në pikën e mohimit të ekzistencës së tyre – shiqo përgjigjet e zyrtarëve për të drejtat e njeriut në komunën e Junikut dhe Parteshit-Pasjan.

**Tabela 1. Përgjigjet nga zyrtarët në komuna mbi të drejtat e njeriut/mbrojtja nga diskriminimi**

Kërkesa për institucionet (Komuna)	Data e kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigja e pranuar
Deçan/Dečane	12.10.2017	-	Pa përgjigje.
Dragash/Dragaš	12.10.2017	-	Pa përgjigje.
Drenas/Glogovac	12.10.2017	-	Pa përgjigje.
Ferizaj/Uroševac	12.10.2017	-	Pa përgjigje.
Fushë Kosovë/ Kosovo Polje	12.10.2017	13.10.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI. Mungon mbështetja financiare për këtë.
Gjakova/Djakovica	12.10.2017	27.10.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI.
Gjilan/Gnjilane	12.10.2017	-	Pa përgjigje.
Graçanicë/Gračanica	16.02.2018	22.02.2018	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI.
Hani i Elezit/Elez Han	12.10.2017	16.10.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI.
Istog/Istok	12.10.2017	16.10.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI dhe asnjë zyrtarë publik nuk ka marrë pjesë në trajnime të tilla.
Junik/Junik	12.10.2017	27.10.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI. Kjo është për shkak se nuk është identifikuar asnjë rast LGBTI në komunën tonë.

<sup>26</sup> Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut - Kosovo and Qendra për Zhvillimet e Grupeve Shoqërore, Liria, dhe Mbrojtja për Lez-biket, Homoseksualët, Biseksualët dhe Transgjindorët në Kosovë, (Prishtina, Kosovë, Nëntor 2013).

<sup>27</sup> Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore – CSGD dhe Qendra për Barazi dhe Liri – CEL, Raporti Vjetor 2016: Reflektim mbi të Drejtat e LGBTI në Kosovë, (Prishtina, Kosovë Nëntor 2016).

Kaçanik/Kaçanik	12.10.2017	26.10.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI. Asnjë rast informacioni apo ankese mbi LGBTI.
Kamenicë/Kamenica	12.10.2017	16.10.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI.
Klinë/Klina	12.10.2017	-	Pa përgjigje.
Kllokot/Klokot	16.02.2018	-	Pa përgjigje.
Leposavic	-	-	Uebfaqja në ndërtim e sipër/asnjë kontakt në listën e pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. <sup>28</sup>
Lipjan/Lipjan	12.10.2017	-	Pa përgjigje.
Malishevë/Mališevo	12.10.2017	26.10.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI.
Mamushë/Mamuša	12.10.2017	13.10.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI.
Mitrovica Veriore/ Severna Mitrovica	16.02.2018	-	Pa përgjigje.
Mitrovicë/Mitrovica	12.10.2017	16.10.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI.
Novobërdë/Novo Brdo	12.10.2017	26.10.2017	Po, kam pranuar emailin por ne nuk kemi raste të tilla, kështu që as nuk e kam plotësuar pyetësin. Po ju tregoj tani verbalisht sepse nuk kam asgjë për të shkruar në email dhe as nuk kam kompjuter.
Obiliq/Obilič	12.10.2017	16.10.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI. Ndihem keq që nuk isha në gjendje të vendos më shumë informata në pyetësor, por jam i/e hapur për çfarëdo bashkëpunimi dhe i mirëpres trajnimet e tilla.
Partesh-Pasjan/ Parteš-Pasjane	16.02.2018	19.02.2018	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI. Mungon mbështetja financiare për këtë dhe nuk kemi të dhëna për anëtarë ekzistues të komunitetit LGBTI në komunën tonë. Mirëpo, disa zyrtarë të komunës kanë marrë pjesë në seminare për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e minoriteteve, pëfshirë edhe të drejtat e popullatës LGBTI. Seminaret janë organizuar nga UNDP, USAID dhe OJQ-të lokale: CSD-Gračanica, Perspektiva Evropiane - Pristina.

<sup>28</sup> Teuta Fazliu, "RE: Lista e zyrtareve për të drejtat e njeriut në komuna" [RE: List of human rights officials in municipalities], Email CSGD-së, 9 Tetor 2016.

Pejë/Peč	12.10.2017	-	Pa përgjigje.
Podujevë/Podujevo	12.10.2017	-	Pa përgjigje.
Prishtinë/Priština	12.10.2017	16.10.2017	Nuk ka pas trajnim specifik mbi të drejtat LGBTI por janë përmendur në trajnimet e tjera për të drejtat e njeriut, si të drejta të mbrojtura nga ligji ekzistues për të drejtat e njeriut, gjithashtu edhe nga Kushtetuta e Kosovës. Si njësi për të drejtat e njeriut, ne nuk kemi buxhet për trajnime të tilla dhe kemi nevojë për mbështetjen e organizatave tjera për të organizuar takime me organizatat LGBTI. Si koordinator i drejtave të njeriut, kam marr pjesë në një trajnim mbi Barazi Gjinore dhe të drejtat LGBTI – Luftimin e stereotipeve dhe diskriminimit në nivel lokal, e organizuar nga TAIEX LAF (Institucion i Administratës Lokale) dhe NALAS (Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore).
Prizren/Prizren	12.10.2017	26.10.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI.
Rahovec/Orahovac	12.10.2017	-	Pa përgjigje.
Ranillug/Ranilug	16.02.2018	21.02.2018	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI.
Shtërpçë/Štrpce	16.02.2018	-	Pa përgjigje.
Shtime/Štimlje	12.10.2017	26.10.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI. Kemi pas vetëm një trajnim në këtë temë me OSBE dhe Ministrinë e Arsimit.
Skenderaj/Srbica	12.10.2017	13.10.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI.
Suharekë/Suva Reka	12.10.2017	12.10.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI.
Viti/Vitina	12.10.2017	13.10.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI.
Vushtrri/Vučitrn	12.10.2017	27.10.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI.
Zubin Potok/ Zubin Potok	-	-	Uebfaqja në ndërtim e sipër/asnjë kontakt në listën e pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. <sup>29</sup>
Zvečan/Zvečan	-	-	Uebfaqja në ndërtim e sipër/asnjë kontakt në listën e pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. <sup>30</sup>

<sup>29</sup> *Ibid.*

<sup>30</sup> *Ibid.*

Ngjashëm, ato pak përgjigje të pranuar nga njësitë/zyrtarët në ministri për të drejtat e njeriut/mbrojtje nga diskriminimi tregojnë se nuk kanë mbajtur trajnim mbi të drejtat dhe çështjet LGBTI. Kufizimet financiare janë theksuar si arsye, ndërsa poashtu vihet re edhe mungesa e kuptimit të rolit të njërive/zyrtarëve për të drejtat e njeriut/mbrojtjes nga diskriminimi. Për më tepër, disa nga zyrtarët për të drejtat e njeriut/mbrojtjen nga diskriminimi që janë certifikuar si trajnues për barazi nga projekti i binjakëzimit të BE-së as që janë përgjigjur në kërkesat për informata.

**Tabela 2. Përgjigjet nga zyrtarët në komuna mbi të drejtat e njeriut/mbrojtja nga diskriminimi**

Kërkesa për institucionet	Data e kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigja e pranuar
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës	23.11.2017	01.12.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI. Mirëpo, ka qenë një trajnim mbi Ligjin për Barazi Gjinore, Ligji mbi mbrojtje nga Diskriminimi dhe Ligjimi i Institutit e Avokatit të Popullit, ku koncepti i orientimit seksual dhe identiteti gjinor janë përmendur si baza të mbrojtura. Poashtu është theksuar edhe parimi për trajtim të barabartë.
Ministria e Infrastrukturës	24.11.2017	-	Pa përgjigje.
Ministria e Financave	24.11.2017	29.11.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI. Sidomos nuk kishte trajnime të tilla për zyrtarët e të drejtave të njeriut.
Ministria e Shëndetësisë	24.11.2017	-	Pa përgjigje.
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	24.11.2017	-	Pa përgjigje.
Ministria e Integritetit Evropian	24.11.2017	-	Pa përgjigje.
Ministria e Drejtësisë	23.11.2017	-	Pa përgjigje.
Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë	E themeluar kohët e fundit - nuk ka faqe në internet	-	-
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	24.11.2017	07.12.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI. Mungesa e një trajnuesi për LGBTI brenda institucionit ka qenë një sfidë. Ministria jonë ka filluar të merret me të drejtat e këtij komuniteti duke caktuar një zyrtarë për të drejtat LGBTI.



Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	24.11.2017	-	Pa përgjigje.
Ministria e Punëve të Brendshme	24.11.2017	29.11.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI nga ministria dhe zyrtari për të drejtat e njeriut nuk ka marrë pjesë në asnjë trajnim lidhur me LGBTI.
Ministria e Punëve të Jashtme	24.11.2017	-	Pa përgjigje.
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	24.11.2017	01.12.2017	Ministria nuk ka kërkesë për trajnime mbi të drejtat LGBTI.
Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor	23.11.2017	-	Pa përgjigje.
Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike	24.11.2017	29.11.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI.
Ministria për Komunitete dhe Kthim	24.11.2017	-	Pa përgjigje.
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	06.10.2017	10.10.2017	Një trajnim ndër kolegë në projektin e binjakëzimit i BE-së mbajtur nga zyrtari i komunitetit dhe gjuhës i MAPL-së.
Ministria e Administratës Publike	24.11.2017	05.12.2017	Nuk është organizuar asnjë trajnim mbi të drejtat LGBTI.
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	23.11.2017	-	Pa përgjigje.
Ministria e Zhvillimit Rajonal	E themeluar kohët e fundit - nuk ka faqe në internet	-	-
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	24.11.2017	-	Pa përgjigje.

## 1.4 Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP)

Institucioni i Avokatit të Popullit përfaqëson mekanizmin kryesor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut nga veprimet e paligjshme apo dështimet për të vepruar dhe veprimet e parregullta nga autoritetet publike.<sup>31</sup> Për më tepër, institucioni është ngritur si mekanizëm për barazi dhe promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për Barazi Gjinore dhe Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi.<sup>32</sup> Ndër veprimet e tjera, avokati i popullit vuri në dukje në raportin e tyre të fundit vjetor se pengesa kryesore për komunitetin LGBTI është refuzimi social, kryesisht i dukshëm nëpërmjet abuzimit në familje dhe shkolla, në këtë mënyrë duke i bërë thirrje Qeverisë të ndërmarrë hapa konkret për të shtuar informatat në lidhje me të drejtat LGBTI në sistemin e edukimit<sup>33</sup>. Raporti gjithashtu tërheqë vëmendjen ndaj diskriminimit dhe abuzimit të kryer nga nëpunësit publik. Ekziston një praktikë e përhapur e mospërputhjes me rekomandimet e IAP-së nga ana e autoriteteve publike e cila është e përbërë nga fakti se Kuvendi i Kosovës nuk mbikëqyr dhe nuk siguron respektimin e këtyre rekomandimeve.<sup>34</sup>

Sipas studimeve të mëparshme, për komunitetin LGBTI një nga institucionet më të njohura për të kërkuar ndihmë është Institucioni i Avokatit të Popullit, pas Policisë së Kosovës.<sup>35</sup> Në përgjithësi, IAP ka mbajtur qasje pozitive ndaj të drejtave LGBTI, edhe pse ka mungesë të ndërgjegjësimit mbi çështjet LGBTI në mesin e përfaqësuesve të institucionit, gjë që dëmton rezultatet e punës së tyre drejt mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut<sup>36</sup>.

Sipas përgjigjes së tyre në pyetësor, stafi i IAP-së nuk ka pranuar trajnime të veçanta për komunitetin LGBTI, por të drejtat LGBTI janë trajtuar në kuadër të trajnimeve të tjera të ofruara<sup>37</sup>. Gjithashtu është përmendur që gjatë vitit 2016 me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtar janë organizuar trajnimet: Përkufizimi i Diskriminimit dhe llojeve të tij, dhe Hyrje në Standardet Ndërkombëtare të Mbrojtjes Kundër Diskriminimit (21- 22 Mars); Treguesit e të Drejtave të Njeriut për të zbatuar Paketën e Drejtave të Njeriut dhe për të Matur Mosdiskriminimin dhe Barazinë Gjinore (05-06 Prill); Paraqitja e Ligjit Evropian për të Drejta në Sferën e Mbrojtjes kundër Diskriminimit (20 – 21 Shtator); Diskriminimi në punë: baza ligjore, bazat e mbrojtjes kundër diskriminimit në punë, rastet kryesore dhe praktikat më të mira evropiane (04-05 Tetor); dhe seminari mbi akomodimin e vërejtjeve të ekspertëve të paanshmëm: opinionet me gjykatat vendore dhe ndërkombëtare (09-10 Nëntor). Tregon se disa nga stafi i IAP-së kanë ndjekur trajnimin për t'u bërë trajnues dhe gjithashtu mund të ofrojnë trajnime për të drejtat LGBTI<sup>38</sup>. Megjithatë, është e paqartë nëse këto trajnime kanë adresuar mjaftueshëm çështjet LGBTI për të plotësuar nevojat ekzistuese në këtë drejtim.

<sup>31</sup> Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, 2015, artikulli 1.

<sup>32</sup> *Ibid.*

<sup>33</sup> Institucioni i Avokatit të Popullit, Raporti Vjetor 2016, Nr.16 (Prishtina, Kosovë, 2017), në dispozicion në: [http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Raporti\\_Vjetor\\_2016\\_ANG\\_no16\\_me\\_kopertine\\_per\\_web\\_338158.pdf](http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_2016_ANG_no16_me_kopertine_per_web_338158.pdf).

<sup>34</sup> Komisioni Evropian, Raporti Kosovë\* 2016, Bruksel, 09 Nëntor 2016, në dispozicion në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_kosovo.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf).

<sup>35</sup> Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë dhe Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, *Liria dhe Mbrojtja për Lezbiket, Homoseksualët, Biseksualët dhe Transgjisorët në Kosovë* (Prishtina: Youth Initiative for Human Rights - Kosovo, 2013).

<sup>36</sup> Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore – CSGD, "*Rishikimi: Komuniteti LGBTI dhe të drejtat e tyre në Kosovë–Raporti Vjetor 2017*", (Prishtina, Kosovë).

<sup>37</sup> Merita Syla, "*Lidhur me kërkesën tuaj për çasje në dokument publik*" [Regarding your request for access to a public document], Email CSGD-së, 26 Janar 2018.

<sup>38</sup> *Ibid.*

## 2. ADMINISTRATA

### 2.1 Divizioni i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Kapaciteteve, Ministria e Administratës Publike

Duke vepruar në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, Divizioni i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Kapaciteteve është përgjegjës për hartimin, promovimin dhe koordinimin e zbatimit të politikave për ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në Shërbim Civil të Kosovës, hartimin e procedurave për vlerësimin dhe analizën e nevojave të trajnimit dhe administrimit të skemës në bashkëpunim me IKAP si dhe vlerësimin e ndikimit të trajnimit, dhe koordinimin e aktiviteteve me IKAP për zbatimin e politikave të trajnimit<sup>39</sup>. Pavarësisht nga këto përgjegjësi të gjera dhe të rëndësishme, departamenti nuk ka filluar zbatimin e ndonjë trajnimi lidhur me të drejtat LGBTI<sup>40</sup>.

### 2.2 Departamenti për Performancë dhe Transparencë Komunale, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)

Përgjegjësitë e Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal përfshijnë propozimin, hartimin dhe sigurimin e zbatimit të planeve të zhvillimit të kapaciteteve në komuna, duke ofruar mbështetje në zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit të kapaciteteve në komuna, zhvillimin dhe monitorimin e sistemit për vlerësimin e performancës së komunave, monitorimin e cilësisë së shërbimeve komunale (performancën), monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe komuniteteve në lidhje me shërbimet e ofruara nga komunat, dhe monitorimin e përfaqësimit gjinor dhe krijimin e mundësive të barabarta në komuna<sup>41</sup>. Megjithatë, departamenti nuk ka filluar ose nuk ka përkrahur zbatimin e ndonjë trajnimi që ka të bëjë me të drejtat LGBTI, përveç projektit të binjakëzimit me BE-në, me trajnimin ndër kolegjetë ofruar nga Zyrtari i Komunitetit dhe Gjuhëve të MAPL-së<sup>42</sup>.

### 2.3 Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP)

Instituti i Kosovës për Administratë Publike është institucion qendror qeveritar që vepron në kuadër të Ministrisë për Administratë Publike, dhe luan një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve civile të ofruara nga administrata publike e Kosovës dhe rritjes së qëndrueshmërisë së shërbimit civil. Obligimet e IKAP-it përfshijnë këshillimin dhe mbështetjen e Ministrisë së Administratës Publike në përgatitjen dhe zbatimin e strategjive të trajnimit, megjithëse përgjegjësitë primare të institutit janë të identifikojnë dhe vlerësojnë nevojat e nëpunësve civilë në të dyja nivelet, qendror dhe lokal, pasuar nga zhvillimi dhe ofrimi i trajnimeve për t'i përmbushur këto nevoja. Këto trajnime kanë nevojë për vlerësim, diskutim dhe studim për të zhvilluar kapacitetet e nëpunësve civil.<sup>43</sup>

<sup>39</sup> Qeveria e Kosovës, Ministria e Administratës Publike, <https://map.rks-gov.net/Departments/DASHC/Divizioni-i-Menaxhimit-te-Burimeve-Njerezore-dhe-Z.aspx>, qasur më 21 Janar 2018.

<sup>40</sup> Haki Leci, "Pergjigje" [Reply], Email CSGD-së, 05 Dhjetor 2017.

<sup>41</sup> Qeveria e Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, <https://mapl.rks-gov.net/Main-menu/Departamentet/Departament-i-Planifikimit-dhe-Reformes-se-Pushtetit.aspx>, qasur më 21 Janar 2018.

<sup>42</sup> Rozafa Ukimeraj, "Pergjigje në kërkesë për qasje në dokumente publike" [Reply on the request for access to public documents], për Arbër Nuhiu, 10 Tetor 2017.

<sup>43</sup> Ligji Nr. 04/L-221 mbilnstitutin për Administratë Publike të Kosovës, 2014, artikulli 5.

Përkundër mos përvojës së mëparshme të bashkëpunimit me organizatat LGBTI, IKAP ka ndërrmarrë përgjegjësi të rëndësishme për zbatimin e rekomandimeve të ZQM/GKK-së dhe ofrimin e edukimit të vazhdueshëm duke marrë iniciativë për të identifikuar barrierat që ekzistojnë ndaj të drejtave LGBTI për shkak të qëndrimit dhe injorancës së nëpunësve publik.

Drejtoresha e IKAP-it znj. Refike Sulcevc shprehu angazhimin për zbatimin e rekomandimeve të adresuara ndaj institucionit të saj në *"Konferencën e Përbashkët mbi Mbrojtjen e përfshirjes së trajnimit për ngritjen e vetëdijes për barazi dhedrejtat LGBTI në institucionet publike të Kosovës"*<sup>44</sup>, pas të cilës ZQM demonstroi këmbëngulje në këtë drejtim. Duke iu përgjigjur detyrimeve të krijuara nga Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (NPISAA) dhe rekomandimet e GKK-së, ZQM ka hartuar programin e trajnimit për të drejtat e njeriut dhe modulën që ka për qëllim promovimin e barazisë, të cilin e ka dorëzuar në IKAP<sup>45</sup>. Informatat e ofruara nga IKAP tregojnë që programi ishte mjaft i plotë, me një pjesë të konsiderueshme të fokusuar në kornizën ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe mekanizmat për të drejtat e njeriut, dhe një segment relativisht të vogël që mbulon rolet gjinore dhe homofobinë mes të drejtave tjera<sup>46</sup>. Kjo është sigurisht një hap pozitiv për ZQM dhe IKAP, megjithëse, duke konsideruar rezistencën e lartë ndaj të drejtave LGBTI, duhet të ketë një program trajnues special mbi këtë, ngjashëm me atë të barazisë gjinore<sup>47</sup>.

Plani i zbatimit të PKZMSA 2017 nga IKAP përfshinë trajnimin e trajnerëve për këtë modul, ndërsa trajnuesit e barazisë të certifikuar nga projekti i binjakëzimit të BE-së duhet të përfshihen në bazën e të dhënave të trajnuesve të IKAP-it<sup>48</sup>. Kjo është problematike për shkak të dallimeve në mes të modulit të të drejtave të njeriut të IKAP-it dhe programit të trajnimit të projektit të binjakëzimit të BE-së, që do të thotë se trajnimet zhvillohen në standarde të ndryshme dhe rezultojnë në trajnues të cilët kanë nivele të ndryshme të kompetencës, por të gjitha do të shtohen në bazën e të dhënave të IKAP-it. Në fakt, kjo është gjithashtu një tregues i mungesës ose improvizimit të qëndrueshmërisë së projektit të binjakëzimit.

Përveç kësaj, IKAP nuk ka ofruar ende asnjë trajnim për të drejtat dhe çështjet LGBTI përveç mbështetjes së dy prej seancave trajnuese të projektit të binjakëzimit të BE-së duke lejuar përdorimin e objekteve të tyre të trajnimit<sup>49</sup>.

Sa i përket **rekomandimeve të GKK-së në lidhje me administratën**, siç është elaboruar më lart, IKAP ka filluar zbatimin e rekomandimit për përfshirjen e trajnimit për barazi në programin e tyre, megjithëse të drejtave LGBTI nuk u është kushtuar mjaft vëmendje brenda kornizës së kurikulës së trajnimit. Rekomandimi tjetër në lidhje me përkrahjen institucionale dhe financiare për të kryer dy trajnime njëditore në vit për ministri nuk është zbatuar nga asnjë ministri, as nuk ka rekomandim tjetër për zhvillim të vazhdueshëm profesional për trajnuesit e barazisë përmes shkëmbimit ndërkombëtar. Kjo mund të jetë për shkak se rekomandimet janë shumë të gjera dhe joreale.

<sup>44</sup> Procesverbal nga "Konferenca e përbashkët për mbrojtjen e përfshirjes së trajnimit të ndërgjegjësimit mbi të drejtat e LGBTI në institucionet publike të Kosovës", 16 Mars 2016, Ndërtesa e Qeverisë së Kosovës.

<sup>45</sup> Habit Hajredini, "Kërkesë për përfshirjen në programin e trajnimeve të IKAP-it të Programit dhe Modulit të trajnimit për të Drejtat e Njeriut me fokus në promovimin e BARAZISË / i specializuar për inkurajimin e mundësive të barabarta dhe si dhe promovimin e trajtimit të barabartë për një shoqëri gjithëpërfshirëse" [Request for inclusion of the human rights training program and module focusing on the promotion of equality / specializing in encouraging equal opportunities and promoting equal treatment for a comprehensive society in the KIPA training program], për Refike Sulcevc, 06 Shkurt 2017.

<sup>46</sup> Enver Haxhijaj, "RE: Kërkesë për qasje në dokumente publike" [RE: Request for access to public documents], Email CSGD-së, 17 Nëntor 2017.

<sup>47</sup> Instituti i Kosovës për Administratë Publike, "Planprogrami për Barazi Gjinore" [Gender Equality Curriculum], Shtator 2016.

<sup>48</sup> Enver Haxhijaj, "RE: Kërkesë për qasje në dokumente publike" [RE: Request for access to public documents], Email CSGD-së, 09 Nëntor 2017.

<sup>49</sup> Enver Haxhijaj, "RE: Kërkesë për qasje në dokumente publike" [RE: Request for access to public documents], Email CSGD-së, 17 Nëntor 2017.

### 3. ARSIMI

Sistemi arsimor është një nga mirëmbajtësit më të shquar të paragjykimit, refuzimit dhe dhunës kundër komunitetit LGBTI në Kosovë. Përveç diskriminimit dhe dhunës që ndodhin në shkolla në duart e personelit, sistemi aktual arsimor në Kosovë mëson paragjykimin dhe refuzimin e komunitetit LGBTI<sup>50</sup>. Prandaj, një numër i rekomandimeve të GKK-së i është adresuar sektorit të arsimit, që do të thotë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Zëvendësja e ministrit të atëhershëm të MASHT-it, znj. Anila Statovci-Demaj, e cila kishte marrë pjesë personalisht në "Konferencën e Përbashkët mbimbrotjen e përfshirjes së trajnimit për ngritjen e vetëdijes për barazi dhedrejtat LGBTI në institucionet publike të Kosovës", theksoi përkushtimin e institucionit të saj në avancimin e të drejtave të njeriut/LGBTI, ndërkohë duke siguruar pjesëmarrësit në konferencë se MASHT-i ka filluar punën në këtë fushë përpara rekomandimeve të GKK-së. Megjithatë, kur u kontakuan për informacionin e kërkuar për progresin e MASHT-it në zbatimin e rekomandimeve dhe programet e tyre të mëparshme të trajnimit në lidhje me të drejtat dhe çështjet LGBTI, nuk kishte përgjigje as nga kabineti i ministrit aktual, as nga zyrtari për qasje në dokumente publike. Nuk ka pasur asnjë përgjigje as nga Zyrtarët për Drejtat e Njeriut/Mbrojtje nga Diskriminimi të cilët janë anëtarë të GKK-së dhe trajnues të certifikuar për barazi nga projekti binjakëzues i BE-së<sup>51</sup>.

Prandaj, nuk ka asnjë informacion nëse mbështetja financiare për gjashtë ditë trajnimi në vitin 2016 është siguruar ose nëse programet e trajnimit do të inkorporohen në projektet e vazhdueshme dhe planet e veprimit dhe ndërtimin e kapaciteteve lidhur me politikën miqësore të shkollës ndaj LGBTI siç rekomandohet nga GKK.

Në anën tjetër, hulumtimi dytësor tregon që kurrikula bërthamë e ndryshuar për arsim parashkollor dhe arsim fillor (klasat 0, I, II, III, IV dhe V), arsim të mesëm të ulët (klasat VI, VII, VIII dhe IX) dhe arsim të mesëm të lartë (klasat X, XI dhe XII) është aprovuar në Tetor 2016. Fjala LGBT është përfshirë në seksionin e Edukimit për Qytetari Demokratike të çështjeve ndër-kurrikulare në kurrikulën bërthamë të të gjitha niveleve të arsimit, por nuk ka qenë mjaft e qartë nëse kjo i referohet vetëm aspektit të të drejtave LGBTI ose nëse shtrihet edhe te çështjet LGBTI. Më tepër, kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë brenda kornizës së punës të temës "Shoqëria dhe Mjedesi" adreson konceptet e identitetit individual, vlerat dhe qëndrimet shoqërore, megjithatë identiteti gjinor dhe seksual janë përmendur vetëm në mënyrë eksplicite në kurrikulën bërthamë të arsimit të mesëm të lartë. Prandaj rekomandimet e GKK-së për përfshirjen e barazisë dhe çështjeve LGBTI në kurrikulë, dhe njohja e barazisë dhe çështjeve LGBTI si çështje ndërlidhëse, janë zbatuar. Megjithatë, sukcesi i këtij ndryshimi duhet të vlerësohet tutje, duke pasur parasysh që deri tani ndryshimi i kurrikulës nuk është përcjellur me ndryshimin e teksteve shkollë, të cilat janë vlerësuar të kenë përmbajtje të papërshtatshme dhe diskriminuese ndaj grupeve të caktuara shoqërore duke përfshirë edhe komunitetin LGBTI<sup>52</sup>.

<sup>50</sup> Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut - Kosovo and Qendra për Zhvillimet e Grupeve Shoqërore, *Liria, dhe Mbrojtja për Lezbiket, Homoseksualët, Biseksualët dhe Transgjiorëtnë Kosovë*, (Prishtina, Kosovë, Nëntor 2013).

<sup>51</sup> CSGD, "Kërkesë për qasje në dokumente publike" [Request for access to public documents], Email to Shyqyri Bytyqi, Alush Istogu, Merita Jonuzi, Fatime Jasiqi, Shpresa Kokollari, 24 Nëntor 2017.

<sup>52</sup> Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë, "Gjuha diskriminuese në tekstet shkollë: Analizë e teksteve shkollë të nivelit të mesëm të lartë në Kosovë", Nëntor 2017, në dispozicion në <http://yih-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/YIHR-KS-Discriminatory-language-in-school-textbooks.pdf>.

## 4. KUJDESI SHËNDETËSOR

Përkundrazi që ligji për mbrojtjen nga diskriminimi e ndalon diskriminimin në mbrojtje shëndetësore<sup>53</sup> dhe ligji për shëndetësi përcakton ofrimin e kujdesit shëndetësor që bazohet në parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit me orientim të përcaktuar seksual,<sup>54</sup> kujdesi shëndetësor mbetet një sektor publik në të cilin komuniteti LGBTI ballafaqohet me stigmatizim dhe diskriminim. Personat LGBTI kanë raportuar se ndjehen të diskriminuar dhe marrin trajtim të cilësisë së dorës së dytë nga personeli shëndetësor; në një rast, një homoseksual i cili kërkoi ndihmë mjekësore në spital për dhimbje stomaku i është thënë që “ai” [ishte] ndoshta shtatzënë pasi që [ai] ndoshta i pëlqen burrat”.<sup>55</sup> Kohët e fundit, një tjetër homoseksual i cili ishte viktimë e ngacmimeve seksuale, i është refuzuar ndihma mjekësore nga një mjek në spitalin e Pejës/Peç<sup>56</sup>. Stafi profesional i shëndetësisë vetë kanë konfirmuar që ka qëndrime paragjyquese dhe trajtim joadekuat. Në një rast një profesionist shëndetësor deklaroi se ishte në gjendje të përcaktonte orientimin seksual të pacientëve në bazë të ekzaminimit psikologjik, derisa të tjerët deklaruan që kjo mund të bëhet në bazë të testimit të hormoneve dhe statusit civil – “ai (ajo) plotëson të gjitha kushtet për t’u martuar, por nuk është i/e martuar”.<sup>57</sup>

Homoseksualiteti përceptohet si sëmundje mendore nga profesionistët shëndetësor në përgjithësi, gjë që ndikon në mënyrën se si i trajtojnë pacientët e tyre, shpesh në mënyrë të papërshtatshme, poashtu kontribuon në vazhdimin e refuzimit shoqëror të komunitetit LGBTI. Përkundër kësaj situate, sektori i shëndetësisë nuk është përfshirë në listë të rekomandimeve të GKK-së. Zyrtari për Mbrojtjen e Drejtave të njeriut/Mbrojtjes nga Diskriminimi në Ministrinë e Shëndetësisë, i cili është certifikuar si trajnues për barazi nga projekti i binjakëzimit të BE-së, nuk i është përgjigjur kërkesës për informatë nëse ministria ka kryer ndonjë trajnim për të drejtat dhe çështjet LGBTI<sup>58</sup>.

Më tutje, Ligji për Shëndetësi krijon odat e profesionistëve të shëndetit për të kryer vetë-rregulloret dhe mbikëqyrje profesionale në punë, trajnim, dhe zhvillim të vazhdueshëm profesional të profesionistëve shëndetësor<sup>59</sup>. Megjithatë, detajet e kontakteve të tyre dhe aktivitetet lidhur me trajnimet e organizuara nuk janë pasqyruar qartë në uebfaqen e Ministrisë së Shëndetësisë<sup>60</sup>. Rrjedhimisht, nuk mund të thuhet nëse ndonjë prej trajnimeve të tyre përfundimtare mbi etikën profesionale i referohet të drejtave LGBTI, ose që çështjet LGBTI janë diskutuar në ndonjë nga trajnimet e tyre profesionale.

<sup>53</sup> Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, 2015, kapitulli I, artikulli 2/1.5.

<sup>54</sup> Ligji Nr. 04/L-125 mbi Shëndetin, 2013, kapitulli II, artikulli 5/1.2.

<sup>55</sup> Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut - Kosovo and Qendra për Zhvillimet e Grupeve Shoqërore, *Liria, dhe Mbrojtja për Lezbiket, Homoseksualët, Biseksualët dhe Transgjitorët në Kosovë*, (Prishtina, Kosovë, Nëntor 2013).

<sup>56</sup> Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore – CSGD, “*Rishikimi: Komuniteti LGBTI dhe të drejtat e tyre në Kosovë—Raporti Vjetor 2017*”, (Prishtina, Kosovë).

<sup>57</sup> Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut - Kosovo dhe Qendra për Zhvillimet e Grupeve Shoqërore, *Liria, dhe Mbrojtja për Lezbiket, Homoseksualët, Biseksualët dhe Transgjitorët në Kosovë*, (Prishtina, Kosovë, Nëntor 2013).

<sup>58</sup> CSGD, “Kërkesë për qasje në dokumente publike” [Request for access to public documents], Email to Sanie Kiçmari, 24 Nëntor 2017.

<sup>59</sup> Ligji Nr. 04/L-125 mbi Shëndetësi, 2013, kapitulli XIII, artikulli 78/4.

<sup>60</sup> Qeveria e Kosovës – Ministria e Shëndetësisë, <http://msh-ks.org/odat-e-profesionisteve-shendetesor/>, qasur më 26 Janar 2018..

## 5. ZBATUESIT E LIGJIT

### 5.1 Prokuroria dhe gjyqësori

Stigma e lidhur me komunitetin LGBTI dhe ndikimi i madh i vlerave tradicionale nuk e kursen profesionalizmin e zbatuesve të ligjit. Përshtypja se zbatuesit e ligjit kanë një kuptim më të mirë për të drejtat e garantuara LGBTI dhe përgjegjësi profesionale ndaj parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, nuk e përfaqëson realitetin. Studimet që synojnë këtë kategori të zbatuesve të ligjit nënkuptojnë se ekziston tendenca për të mohuar ekzistencën e dhunës ndaj komunitetit LGBTI, dhe në njëfarë mase, mohimin e ekzistencës së komunitet LGBTI<sup>61</sup>. Prokurorët dhe gjykatësit kanë treguar kryesisht një shqetësim në trajtimin e rasteve LGBTI dhe madje kanë raportuar që nuk kanë trajtuar disa raste të raportuara të dhunës kundër personave LGBTI<sup>62</sup>. Ose, siç ka ndodhur në rastin e parë të zgjidhur LGBTI, gjykata dështoi të kualifikoj rastin si një krim i bazuar në orientim seksual, pavarësisht regjistrimit se fyerjet ishin të bazuara në orientimin seksual të viktimave<sup>63</sup>, duke manifestuar qartë tendencën për të minimizuar ose edhe të arsyetojnë dhunën kundër komunitetit LGBTI.

Veprimet e institucioneve përkatëse që janë përgjegjëse për zhvillimin profesional të prokurorëve dhe gjyqtarëve janë shqyrtuar, pasi që shqetësimet lidhur me qëndrimet e prokurorëve dhe gjyqtarëve ndaj komunitetit LGBTI tashmë janë ngritur nga raporte dhe forume të ndryshme të avokimit, duke përfshirë rekomandimet e GKK-së.

#### 5.1.1 Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)

Këshilli Prokurorial i Kosovës është një institucion i pavarur për sigurimin e pavarësisë, profesionalizmit dhe paanësisë së sistemit të prokurorisë<sup>64</sup>. Përveç rekrutimit dhe propozimit të prokurorëve në përputhje me standardet e vendosura nga vetë institucioni dhe mbikëqyrjesë performancës së prokurorëve, detyrat e KPK-së gjithashtu përfshijnë përcaktimin e politikave, standardeve dhe udhëzimeve lidhur me trajnimin e prokurorëve dhe personelit tjetër, dhe mbikëqyrjen e zbatimit të trajnimit profesional dhe zhvillimit të prokurorëve nga ana e Akademisë së Drejtësisë dhe shoqatave, dhe organizata tjeratë trajnimit<sup>65</sup>.

Në përgjigje të kërkesës për informata, Këshilli Prokurorial i Kosovës raportoi se kishte organizuar një trajnim një ditë mbi temën "Barazia dhe Konceptet Kryesore të Diskriminimit", që përfshinte të drejtat LGBTI. Sipas përgjigjes së KPK-së, trajnimi u iniciua nga zyra e tyre e trajnimit dhe u mbështet nga Akademia e Drejtësisë dhe Këshilli Gjyqësor të Kosovës në rolet bashkë-trajnuese. Në të morën pjesë disa prokurorë dhe mbrojtës të viktimave të krimit<sup>66</sup>.

<sup>61</sup> Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut - Kosovo and Qendra për Zhvillimet e Grupeve Shoqërore, *Liria, dhe Mbrojtja për Lezbiket, Homoseksualët, Biseksualët dhe Transgjinerorët në Kosovë*, (Prishtina, Kosovë, Nëntor 2013).

<sup>62</sup> *Ibid.*

<sup>63</sup> Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore – CSGD dhe Qendra për Barazi dhe Liri – CEL, Raporti Vjetor 2016: Reflektim mbi të Drejtat e LGBTI në Kosovë, (Prishtina, Kosovë Nëntor 2016).

<sup>64</sup> Ligji Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, 2010, kapitulli II, artikulli 3.

<sup>65</sup> *Ibid.*, kapitulli II, artikulli 4.

<sup>66</sup> Sylejman Sopa, "Plotësim i pyetësorit" [Filled in questionnaire], Email CSGD-së, 09 Nëntor 2017.

Në fakt, ky trajnim ishte në të vërtetë një trajnim i njëri tjetrit (ndër kolegë) në kuadër të projektit të binjakëzimit të BE-së, i cili nuk u pasua me trajnime shtesë siç rekomandohet nga GKK. Sipas KPK-së, sfidat kryesore për organizimin e trajnimeve të tilla dhe përfshirjen e kësaj teme në trajnimin e vazhdueshëm, janë mungesa e burimeve financiare dhe mungesa e interesit të prokurorëve për të ndjekur trajnimet lidhur me të drejtat LGBTI<sup>67</sup>.

### 5.1.2 Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)

Këshilli Gjyqësor i Kosovës është një institucion i pavarur i vendosur për të siguruar pavarësinë, drejtësinë, paanësinë, dhe profesionalizmin e sistemit gjyqësor.<sup>68</sup> Në koordinim me Akademinë e Drejtësisë, është gjithashtu përgjegjës për përcaktimin e politikave dhe standardeve të trajnimit, si dhe sigurimin e trajnimeve për gjyqtarë dhe stafin gjyqësor<sup>69</sup>. Aktualisht ekziston një kërkesë që gjykatësit e sapoemëruar t'i nënshtrohen një programi fillestar trajnues të detyrueshëm 12 mujor, megjithatë performanca dhe vullneti i gjyqtarëve në trajtimin e rasteve LGBTI mbetet i dobët. Kjo mangësi e gjyqësorit është vërejtur edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën 2016, i cili këshillon përfshirjen e një moduli mbi antidsikriminim në kurrikulate trajnimit.

Në kërkesën për informacion nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, drejtori i Njësisë së Shqyrtimit të Performancës së Gjykatës z. Hydajet Hyseni është përgjigjur duke thënë se nuk kishte informacion për të dhënë lidhur me rekomandimet e GKK-së dhe trajnimin për të drejtat LGBTI. Ai kërkoi nga kolegët të japin informatat e tyre, por asnjëri prej tyre nuk është përgjigjur, përfshirë anëtarët e GKK-së që përfaqësojnë KGJK-në<sup>70</sup>.

Bazuar në përgjigjen e Këshillit Prokurorial të Kosovës, znj. Mejreme Zeka nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës ishte bashkë-trajnuese e trajnimit të kolegëvenë kuadër të projektit të binjakëzimit të BE-së<sup>71</sup>.

### 5.1.3 Akademia e Drejtësisë (AD)

Akademia e Drejtësisë është një institucion i pavarur funksionet e të cilit përfshijnë krijimin e programeve trajnuese dhe organizimin e trajnimeve për gjyqtarët dhe prokurorët shtetit në përputhje me ligjin në fuqi, zhvillimin e procesit të vlerësimit të nevojave për trajnim përmes mekanizmave të formuara nga Akademia dhe në bazë të kërkesave të KGJK-së dhe KPK-së, organizimin e trajnimeve të vazhdueshme profesionale për avokatët e shtetit, juristët, dhe profesionet tjera në bazë të vlerësimit të Akademisë, në përputhje me kërkesat e institucioneve kompetente, zhvillimin dhe zbatimin e programeve të trajnimit në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në dhe në bashkëpunim me odat përkatëse të profesioneve të hapura ose institucionet përkatëse, kryerjete analizave, hulumtimeve dhe bashkëpunon me institucionet shkencore<sup>72</sup>.

Përveç trajnimit të kolegëve të organizuar në bashkëpunim me KPK-në dhe KGJK-në për barazi në kontekstin e legjislacionit kundër diskriminimit në Korrik 2015 në kuadër të projektit të binjakëzimit të BE-së, Akademia e Drejtësisë raportoi që gjithashtu kanë organizuar trajnime të tjera të ngjashme<sup>73</sup>.

<sup>67</sup> *Ibid.*

<sup>68</sup> Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, 2010, kapitulli II, artikulli 3.

<sup>69</sup> *Ibid.*, kapitulli VIII, artikulli 50.

<sup>70</sup> Hydajet J. Hyseni, "FW: Kërkesë për qasje në dokumente publike" [FW: Request for access to public documents], Email CSGD-së, 03 Nëntor 2017.

<sup>71</sup> Sylejman Sopa, "Materiali i trajnimit" [Training material], Email CSGD-së, 10 Nëntor 2017.

<sup>72</sup> Ligji Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, kapitulli II, artikulli 6.

<sup>73</sup> Fitore Zariqi, "Përgjigje në kërkesë" [Answer to the request], Email CSGD-së, 17 Nëntor 2017.



Kalendari i Akademisë së Drejtësisë në internet tregon që janë organizuar dy trajnime të ngjashme, një më 02 Shkurt 2017<sup>74</sup> dhe tjetra më 23 Qershor 2016<sup>75</sup>, duke adresuar pjesërisht rekomandimet e GKK-së që kërkoi ofrimin e mbështetjes institucionale dhe financiare për shtatë trajnime dy ditore për prokurorët dhe gjykatësit në 7 regjione të Kosovës, brenda periudhës 2016 dhe 2017. Sidoqoftë, çështjeve LGBTI nuk i është kushtuar vëmendje e mjaftueshme brenda programit të trajnimit<sup>76</sup> për t'u dhënë pjesëmarrësve një njohuri më të gjerë të dobishme për praktikën e tyre profesionale. Për më tepër, programi trajnues i AD-së për vitin 2018 në kuadër të trajnimeve për mosdiskriminim është i kufizuar në barazinë gjinore dhe nuk përfshin të drejtat dhe çështjet LGBTI<sup>77</sup>.

Dy rekomandimet e tjera të GKK-së për të organizuar shkëmbime të vazhdueshme ndërmjet ekspertëve të Kosovës dhe BE-së për rastet gjyqësore/të prokurorisë në sferat e barazisë dhe të drejtave LGBTI, dhe për të mbështetur shkëmbimet ndërkombëtare dhe pjesëmarrjen në konferenca, si të gjera dhe joreale siç janë, kanë mbetur të pazgjidhura nga mekanizmat përkatës të prokurorisë dhe gjyqësorit.

## 5.2 Policia e Kosovës (PK)

Krahasuar me institucionet tjera, Policia e Kosovës është marrë me një numër më të madh të rasteve të raportuara, dhe studimet tregojnë gjithashtu një nivel më të lartë të besimit dhe ndërgjegjësimit për rolin e institucionit në mesin e komunitetit LGBTI. Ndryshe nga nëpunësit e tjerë publik, studimet e mëparshme kanë treguar se pjesëtarët e Policisë së Kosovës kanë marrë trajnime për të drejtat LGBTI nga institucioni i tyre, qeveria lokale dhe organizatat e shoqërisë civile<sup>78</sup>. Megjithatë, gjithashtu ka dëshmi se komuniteti LGBTI nuk merr gjithmonë një përgjigje adekuate ose nuk është i detyruar t'i nënshtrohet një procesi të fuqishëm gjatë raportimit të rasteve, pavarësisht gatishmërisë së policisë për t'u marrë me raste të tilla<sup>79 80</sup>.

Në përgjigjen e tyre ndaj kërkesës për qasje në dokumente publike, përfaqësuesit e Policisë së Kosovës deklaruan se kanë zbatuar trajnimet e kolegëve të organizuara në kuadër të projektit të binjakëzimit të BE-së, dhe shpjeguan se trajnimet e detyrueshme tre orëshe për të gjitha Drejtoritë Rajonale janë ndjekur<sup>81</sup>. Si rezultat, më shumë se 400 përfaqësues të policisë, duke përfshirë mbikëqyrësit e nivelit të parë, hetuesit dhe oficerët e policisë në nivel të Drejtorive Rajonale të Policisë kanë marrë pjesë në trajnime që kanë të bëjnë me barazinë dhe të drejtat LGBTI<sup>82</sup>. Sidoqoftë, shkëmbimi i njohurive me institucionet e policisë nga vendet e tjera mbi mënyrën e trajtimit të çështjeve LGBTI në punën e tyre është theksuar si një nevojë për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të policisë<sup>83</sup>.

<sup>74</sup> Qeveria e Kosovës – Akademia e Drejtësisë, <https://ad.rks-gov.net/en/training-calendar/TrainingDetails/676?controller=Trainings&programId=1>, qasur më 27 Janar 2018.

<sup>75</sup> Qeveria e Kosovës – Akademia e Drejtësisë, <https://ad.rks-gov.net/en/training-calendar/TrainingDetails/531?controller=Trainings&programId=1>, qasur më 27 Janar 2018.

<sup>76</sup> Sylejman Sopa, "Materiali i trajnimit" [Training material], Email CSGD-së, 10 Nëntor 2017.

<sup>77</sup> Akademia e Drejtësisë, "Programi për Trajnim 2018" Dhjetor 2017.

<sup>78</sup> Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë and Qendra për Zhvillimet e Grupeve Shoqërore, *Liria, dheMbrojtja për Lezbiket, Homoseksualët, Biseksualët dhe Transgjiorëtnë Kosovë*, (Prishtina, Kosovë, Nëntor 2013).

<sup>79</sup> Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut - Kosovës, Marrja e Aksioneve: *Të drejtat e njeriut në Kosovën 2015* (Prishtina: Youth Initiative for Human Rights - Kosovo, 2015).

<sup>80</sup> Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore – CSGD dhe Qendra për Barazi dhe Liri – CEL, *Raporti Vjetor 2016: Reflektimmbi të Drejtat e LGBTI në Kosovë*, (Prishtina, Kosovë Nëntor 2016).

<sup>81</sup> Salih Dragidela, "Kërkesë për qasje në dokumente publike –PYTESORI" [Request for Access to Public Documents – QUESTIONNAIRE], Email CSGD-së, 02 Shkurt 2018.

<sup>82</sup> *Ibid.*

<sup>83</sup> *Ibid.*

### 5.2.1 Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP)

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është një institucion përgjegjës për shumë gjëra: ofrimi i trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimi i politikave dhe strategjive në lidhje me trajnim, arsimin e lartë dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike, dhe shërbimet e saj i dedikohen Policisë së Kosovës midis institucioneve të tjera<sup>84</sup>.

Në përgjigje të kërkesës për informacion drejtuar Departamentit të Trajnimeve dhe Mbështetjes Arsimore, deri sa zyrtarët e AKSP-së deklaruan se nuk kishin trajnime specifike për të drejtat dhe çështjet LGBTI, ata e bënë këtë pa dhënë detaje të tjera siç kërkohej<sup>85</sup>. Megjithatë, përfaqësuesit e Policisë së Kosovës treguan se kurrikula e AKSP-së mbulon të drejtat LGBTI brenda kursit të të drejtave të njeriut për anëtarët e rinjë të policisë së Kosovës dhe për policinë e komunitetit<sup>86</sup>. Programi i kursit mbulon këto aspekte: bazën ligjore për barazi gjinore; kuptimin e termeve homofobia, transfobia dhe LGBT; mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore bazuar në legjislacionin vendor dhe ndërkombëtarë; shkelja e dinjitetit njerëzor, mënyrat e parashikimit të këtyre shkeljeve; analiza e shembujve praktikë të shkeljeve të mundshme të të drejtave të njeriut.

Së fundmi, duke iu referuar përgjigjeve të përfaqësuesve të Policisë së Kosovës,<sup>87</sup> rekomandimet e GKK-së për zbatimin e trajnimeve për barazi me fokus të veçantë në çështjet e lidhura me LGBTI në programin mësimor të trajnimit bazë të Policisë së Kosovës, dhe zbatimi i barazisë dhe çështjeve LGBTI të përfshira në trajnimin në shërbim të Policisë janë materializuar. Megjithatë, është e paqartë nëse grupi i trajnuesve të specializuar është zgjeruar siç rekomandohet.

<sup>84</sup> Ligji Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, kapitulli I, artikulli 2.

<sup>85</sup> Mirsad Sholla, "RE: Kërkesë për qasje në dokumente publike" [RE: Request for access to public documents], Email CSGD-së, 08 Dhjetor 2017.

<sup>86</sup> Salih Dragidela, "Kërkesë për qasje në dokumente publike –PYTESORI"[Request for Access to Public Documents – QUESTIONNAIRE], Email CSGD-së, 02 Shkurt 2018.

<sup>87</sup> *Ibid.*

## KONKLUKIMET

Pavarësisht se të drejtat LGBTI janë futur shumë herët në kornizën ligjore të Kosovës, madje edhe para kushtetutës, promovimi dhe mbrojtja e tyre kanë ngecur në krahasim me standardet e tyre ligjore. Krahas mungesës së përgjithshme të sundimit të ligjit të vendit, vlerat tradicionale të shoqërisë kosovare kanë qenë pengesa kryesore për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave LGBTI. Ky raport, megjithatë, tregon se indiferenca e institucioneve publike ndaj të drejtave LGBTI është sfiduar nga një avokim më i madh dhe nga prania e çështjeve LGBTI.

Është e qartë që deri kohët e fundit nuk ka pasur përpjekje për të luftuar diskriminimin dhe mohimin e të drejtave LGBTI nga nëpunësit publik përmes përmirësimit të njohurive të tyre mbi të drejtat LGBTI dhe të drejtat e tyre të garantuara në Kosovë. Stigma dhe refuzimi i komunitetit LGBTI vazhdon të mbetet i lartë në mesin e nëpunësve publik në përgjithësi, madje edhe në mesin e atyre që janë në rolin e avokatëve dhe zbatuesve të të drejtave të njeriut. Trajnimet e fundit (pothuajse të vetmet që do të mbahen) të organizuara nën kornizën e projektit të binjakëzimit të BE-së kanë bërë një hap fillestar në drejtim të thyerjes së kësaj pengese, megjithëse përmbajtja e tyre mbi çështjet LGBTI ka qenë sipërfaqësore duke kufizuar kuptimin dhe përkthimin e tyre në diskurs të të drejtave dhe obligimeve shtetërore. Për më tepër, qëndrueshmëria e programit nëpërmjet trajnimeve të kolegëve, të siguruara nga trajnuesit për barazitë trajnuar dhe të certifikuar nga BE mbetet e pashpresë. Kjo është për shkak të mungesës së mbështetjes financiare të pjesëmarrësve nga institucionet e tyre përkatëse ose mungesës së interesit të kolegëve të tyre për këtë temë. Përveç kësaj, ZQM në bashkëpunim me IKAP, kanë hartuar një program trajnimi për të drejtat e njeriut me qëllim promovimin e barazisë, me një segment relativisht të vogël të tij që mbulon të drejtat dhe çështjet LGBTI.

Për më tepër, sa i përket zbatimit të rekomandimeve të GKK-së, gati asnjë nga institucionet nuk e ka bërë këtë. Kjo kryesisht tregon pamundësinë e GKK-së si një mekanizëm të ndikojnë politika si dhe mungesën e përvojës së monitorimit të rekomandimeve të tyre. Përndryshe, rekomandimi për përfshirjen e barazisë dhe çështjeve LGBTI si ndërsektoriale në kurrikulën publike të arsimit në Kosovë ishte pothuajse e përfunduar para se të prezantoheshin rekomandimet e GKK-së<sup>88</sup>, ndërsa përfshirja e trajnimit për të drejtat e njeriut me (mungesë) fokus të veçantë në çështjet e lidhura me LGBTI në programin e IKAP-it ka filluar të zbatohet vetëm pasi është inicuar dhe koordinuar nga vetë ZQM-ja. Përveç kësaj, një pjesë e madhe e rekomandimeve të GKK-së ishin shumë të përgjithshme dhe ambicioze.

<sup>88</sup> Procesverbal nga "Konferenca e përbashkët për mbrojtjen e përfshirjes së trajnimit të ndërgjegjësimit mbi të drejtat e LGBTI në institucionet publike të Kosovës" 16 Mars 2016

## REKOMANDIMET

1. Grupi Koordinues Ndërministror për të Drejtat e Njeriut duhet të adresojë të drejtat dhe çështjet LGBTI në punën e tyre;
2. Personeli i Avokatit të Popullit duhet të marrë trajnime për çështjet LGBTI në mënyrë që ata t'i kuptojnë më mirë dhe të jenë në gjendje t'i trajtojnë ato nëpërmjet legjislacionit ekzistues të të drejtave të njeriut;
3. ZQM duhet të mbikëqyrë në mënyrë efektive linjën e ministrive për progresin e zbatimit të rekomandimeve të GKK-së dhe kur është e nevojshme, të ndërmarrin veprime konkrete për të siguruar zbatimin e plotë të këtyre rekomandimeve;
4. Të drejtat e njeriut / njësitë për mbrojtje kundër diskriminimit / zyrtarët në nivel komune dhe ministrie duhet të rrisin kapacitetet e tyre për të drejtat LGBTI dhe të marrin një rol proaktiv në luftën kundër diskriminimit dhe promovimit të barazisë;
5. Instituti i Kosovës për Administratë Publike duhet të ketë një trajnim të veçantë për të drejtat LGBTI dhe çështjet e ngjashme me atë të barazisë gjinore;
6. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të përcjellin ndryshimin e teksteve shkollore sipas planprogrameve të reja dhe duhet t'i adresojë të drejtat dhe çështjet LGBTI në mënyrë të përshtatshme dhe të përballojë hapësirë të mjaftueshme;
7. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të hartojë një program trajnues për barazi duke u fokusuar në të drejtat dhe çështjet LGBTI për mësuesit;
8. Odat e profesionistëve të shëndetësisë duhet të organizojnë trajnime mbi etikën profesionale, duke specifikuar përgjegjësinë e tyre për trajtim të barabartë të komunitetit LGBTI;
9. Odat përkatës të profesionistëve të shëndetësisë duhet të organizojnë trajnime profesionale që mbulojnë çështjet LGBTI, në mënyrë që ata t'i adresojnë ato siç duhet gjatë punës së tyre profesionale;
10. Programi Fillestar i Trajnimit për gjyqtarët e sapoemëruar duhet të përfshijë një modul kundër diskriminimit, duke u fokusuar në të drejtat dhe çështjet LGBTI;
11. Të drejtat dhe çështjet LGBTI duhet të përfshihen në programin e trajnimit të vazhdueshëm të Akademisë së Drejtësisë;
12. Policia e Kosovës duhet të vazhdojë me trajnimet në shërbim të lidhura me të drejtat dhe çështjet LGBTI;
13. Akademia e Kosovës për Siguri Publike duhet të ofrojë më shumë hapësirë për çështjet LGBTI brenda kursit të saj të të drejtave të njeriut për zyrtarët e rinj të policisë dhe policinë e komunitetit.



### Vërejtje

Pyetësori i mëposhtëm do të përdoret për hulumtimin që do të zhvillohet në kuadër të projektit katër (4) vjeçar “Koalicioni - Të drejta të barabartapër të gjithë” (ERAC), i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Bashkimi Evropian në Kosovë. Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojë programet e trajnimit për nëpunësit publik që janë të lidhur me komunitetin LGBTI në Kosovë. Gjetjet do të publikohen në një raport i cili do të prezantohet në një konferencë të organizuar gjatë këtij viti dhe do të ndahet në faqen e internetit të ERAC dhe në mediat sociale në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

### Questionnaire

Emri i institucionit: \_\_\_\_\_

Pozita e zyrtarit në institucion: \_\_\_\_\_

Komuna: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

### KAPITULLI I: Programi i trajnimit

- 1) A ka pasur, apo a ka institucioni juaj ndonjë program trajnimi lidhur me të drejtat e komunitetit LGBTI?
  - a. Po, ka pasur
  - b. Po, ka
  - c. Jo, nuk ka pasur
  - d. Jo, nuk ka
  
- 2) Nëse ka pasur, a ka qenë programi i trajnimit i përfshirë në ndonjë program më të gjerë (p.sh. të drejtat e njeriut) apo ka qenë program i veçantë i trajnimit (ju lutem shpjegoni).

---

---

---

3) Nëse ka, a është programi i trajnimit i përfshirë në ndonjë program më të gjerë (p.sh. të drejtat e njeriut) apo është program i veçantë i trajnimit (ju lutem shpjegoni).

---

---

---

---

---

---

---

4) Nëse programi i trajnimit ka qenë / është përfshirë në ndonjë program më të gjerë, ju lutemi jepni disa informata të përgjithshme mbi përmbajtjen e programit, metodologjinë dhe komponentët që ai mbulon dhe nën cilën pjesë janë përfshirë të drejtat e komunitetit LGBTI.

---

---

---

---

---

---

---

5) Nëse programi i trajnimit në lidhje me komunitetet pakicë është program trajnimi i veçantë, cila është metodologjia dhe cilat janë çështjet që trajtohen (Ju lutem shpjegoni).

---

---

---

---

---

---

---

6) Cila zyrë brenda institucionit tuaj ka inicuar, zhvilluar dhe financuar programin e trajnimit? (Ju lutem shpjegoni).

---

---

---

---

---

---

---

7) A ka qenë ndonjë organizatë tjetër kombëtare ose ndërkombëtare e përfshirë në zhvillimin e programit të trajnimit dhe financimin e organizimit të trajnimeve? (Ju lutem shpjegoni).

---

---

---

---

---

---

---

8) Si u zhvillua programi i trajnimit? Çfarë lloj materiali është përdorur për zhvillimin e programit? A është materiali i trajnimit në dispozicion?

---

---

---

---

---

---

---

9) Si e ka organizuar institucioni juaj programin e trajnimit në lidhje me komunitetin LGBTI: A janë organizuar si një seri trajnimesh (sa ditë) ose vetëm si trajnime të një hershme (sa orë)? A janë organizuar në mënyrë të përsëritur çdo gjashtë (6) muaj ose çdo vit? (Ju lutem shpjegoni).

---

---

---

---

---

---

---

## KAPITULLI II: Pjesëmarrësit e programit të trajnimit

1) Kush kanë qenë pjesëmarrësit e programit të trajnimit?

---

---

---

---

---

---

---

2) Si e ka shpërndarë institucioni juaj informacionin rreth programit dhe si është organizuar procesi i përzgjedhjes së pjesëmarrësve për t'u trajnuar për të drejtat e komunitetit LGBTI? (Ju lutem shpjegoni).

---

---

---

---

---

---

---

3) A janë pajisur pjesëmarrësit me ndonjë certifikatë të pjesëmarrjes në programin e trajnimit në lidhje me komunitetin LGBTI?

- a. Po
- b. Jo

4) A ka pasur ndonjë takim pasues për programin e trajnimit në lidhje me të drejtat LGBTI? Nëse po, ju lutemi shpjegoni procesin dhe kush ishte përgjegjës për organizimin e procesit.

---

---

---

---

---

---

---



- 5) Sa njerëz janë trajnuar për të drejtat e komunitetit LGBTI gjatë tri (3) viteve të kaluara?
- a. 0 – 100
  - b. 101 – 200
  - c. 201 – 300
  - d. 301 – 400
  - e. Më shumë

### **KAPITULLI III: Trajnuesi e programit**

- 1) Si janë zgjedhur trajnuesit për të ofruar trajnime në lidhje me komunitetin LGBTI? (Ju lutem shpjegoni).

---

---

---

---

---

---

---

---

- 2) A ishin trajnuesit e zgjedhur përfaqësues të institucionit tuaj apo ekspertë të pavarur? (Ju lutem shpjegoni).

---

---

---

---

---

---

---

---

- 3) A u janë nënshtruar trajnuesit ndonjë programi para-trajnues të veçantë për të ofruar trajnime në lidhje me të drejtat e komunitetit LGBTI? (Ju lutem shpjegoni).

---

---

---

---

---

---

---

---

4) Nëse po, si është zhvilluar, realizuar dhe kush e financoi trajnimin për trajnuesit? (Ju lutem shpjegoni)

---

---

---

---

---

---

---

---

5) A ndihmuan trajnuesit në zhvillimin e programit të trajnimit? Nëse po, ju lutemi shpjegoni rolin e tyre.

---

---

---

---

---

---

---

---

6) A i kanë trajnuar trajnerët/ ekspertët e programit përfaqësuesit e institucionit tuaj në mënyrë që ata në të ardhmen të mund të ofrojnë trajnime në lidhje me të drejtat e komunitetit LGBTI? (Ju lutem shpjegoni)

- a. Po
- b. Jo

7) Nëse po, ju lutemi jepni një informacion më të detajuar mbi procesin, programin dhe afatin kohor të këtij aktiviteti.

---

---

---

---

---

---

---

---

8) Sa trajnues janë përfshinë në programin e trajnimit për nëpunësit civil lidhur me të drejtat e komunitetit LGBTI (gjatë tri (3) viteve të fundit)?

---

---

---

---

---

---

---

#### **KAPITULLI IV: Sfidat përgjatë procesit**

1) Ju lutemi identifikoni 2-3 sfida me të cilat përballen institucionet tuaja në zhvillimin e programit:

- a. \_\_\_\_\_
- b. \_\_\_\_\_
- c. \_\_\_\_\_

2) Identifikoni 2-3 sfida me të cilat ballafaqohen institucionet tuaja në organizimin e sesionit të trajnimit:

- a. \_\_\_\_\_
- b. \_\_\_\_\_
- c. \_\_\_\_\_

3) Identifikoni 2-3 sfida me të cilat ballafaqohen institucionet tuaja në përzgjedhjen e pjesëmarrësve:

- a. \_\_\_\_\_
- b. \_\_\_\_\_
- c. \_\_\_\_\_

## **ANEKS II – Rekomandimet nga Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues për të Drejtat e Komunitetit LGBT në Kosovë**



### ***Qeveria – Vlada-Government***

*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*

*Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarija za Dobro Upravljanje / Office on Good Governance*

---

**Mars, 2016**

### **Rekomandime për mbrojtjen dhe përfshirjen e qëndrueshmërisë së trajnimit ndërgjegjësues për barazinë dhe të drejtat e komunitetit LGBT në Institucionet Publike të Kosovës**

Qeveria e Kosovës ka themeluar Grupin Këshillëdhënës dhe Koordinues për të drejtat e komunitetit LGBT (Lezbikë, Homoseksual, Biseksualë dhe Transgjynerë) në mbledhjen e mbajtur me datë 18.12.2013 me vendimin nr.05 / 161. Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues për të drejtat e komunitetit LGBT është themeluar për të krijuar partneritet dhe bashkëpunim të rregullt ndërmjet institucioneve ndërkombëtare dhe organizatave joqeveritare që punojnë në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komunitetit LGBT në Kosovë. Për më tepër, formimi i Grupit Këshillëdhënës dhe Koordinues i shërben qëllimit të nismave për aktivitete të përbashkëta për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit të komunitetit LGBT dhe ngritjen e vetëdijes për të drejtat e njeriut, me theks të veçantë në të drejtat e komunitetit LGBT. Përbërja e Grupit është u vendos në mënyrë të tillë që të sigurohej pjesëmarrja e institucioneve kryesore të qeverisë, dhe komunitetit (LGBT) dhe të përmirësojë ndërkombëtarisht përpjekjet e planifikimit dhe të lehtësojë shpërndarjen dhe shkëmbimin e informacioneve, koordinimin dhe bashkëpunimin në këtë fushë ndërmjet akterëve të ndryshëm dhe përkatës.

Me datën 2 Mars 2016, Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues për të drejtat e komunitetit LGBT në Kosovë miratuan në mënyrë unanime rekomandimet e bashkangjitura, duke marrë parasysh kontributin e ekspertëve të projektit të binjakëzimit të BE-së 'Kundër Homofobisë dhe Transfobisë në Kosovë' përpunuar në bashkëpunim të ngushtë me trajnerët për barazi (me fokus të veçantë në trajtim të barabartë të personave LGBT). Rekomandimet përfshijnë sektorin e **arsimit, administratën, gjyqësorin, prokuroritë dhe policinë** dhe synojnë qëndrueshmërinë e programit të trajnimit të BE-së, përkatësisht, vazhdimësinë e trajnimeve të ndërgjegjësimit mbi barazi me fokus të veçantë në çështjet lidhur me LGBT brenda institucioneve qeverisëse të Kosovës.

Me pak fjalë, rekomandimet përshkruajnë nevojat buxhetore për institucionet e përfshira për të vazhduar me aktivitetet trajnuese të ndërgjegjësimit në sektoret e tyre përkatëse. Përveç kësaj, rekomandimet parashikojnë një plan strategjik, mundësi për zhvillim profesional për trajnerët për barazi dhe detaje tjera të nevojshme për qëndrueshmëri të programit të trajnimit nga projekti i binjakëzimit të BE-së 'Kundër Homofobisë dhe Transfobisë në Kosovë'.

Qëllimi i rekomandimeve është të marrin dhe mbështesin nga palët e interesuara të përfshira në zbatimin e këtyre rekomandimeve në mënyrë që të mundësojë një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe trajtim të barabartë dhe mundësi për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Prandaj, Grupi Këshillëdhënës inkurajon palët e interesuara të angazhohen në zbatimin e rekomandimeve të bashkangjitura. Për këtë qëllim, Zyra për Qeverisje të Mirë dhe projekti i lartëpërmendur do të organizojnë një konferencë me datën 16 Mars, 2016 me qëllim të bëhet i dukshëm angazhimi i akterëve të përfshirë.

Ju lutem gjeni më poshtë:

## **Rekomandimet nga Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues për të Drejtat e Komunitetit LGBT në Kosovë**

### **Për fushën e Arsimit**

#### ***Arsimi***

#### **#Rekomandimi: Përfshirja e barazisë & çështjeve të LGBT në kurrikulën e Kosovës**

Pasi që aktualisht është nën shqyrtim, Ministria e Arsimit duhet të garantojë përfshirjen e temës për ndërgjegjësimin mbi barazinë me fokus të veçantë në çështjet lidhur me LGBT në kornizën e kurrikulës së Kosovës. Tema duhet të kuptohet si çështje ndësektoriale. Megjithatë, rekomandohet të përfshihen Barazinë & çështjet e LGBT në fushën e shoqërisë, brenda edukatës qytetare, në kornizën e kurrikulës së Kosovës.

#### ***Arsimi***

#### **#Rekomandimi: Ofrimi i mbështetjes financiare për 6 ditë trajnimi në 2016**

Në 2016, 4-6 grupe (60 deri në 80 pjesëmarrës) do të ndjekin një trajnim të ndërgjegjësimit mbi barazinë me fokus të veçantë në çështjet lidhur me LGBT për grupe të pëziera të mësuesve shkollorë, drejtorëve të shkollave, pedagogëve, këshillit drejtues të shkollave, prindërit, zyrtarët nga Drejtoritë e Arsimit në Komuna, nxënësit, etj. Prandaj, Ministria e Arsimit duhet të ndajë një buxhet përkatës dhe/ose të mbështesë bashkëpunimin me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare që gjenerojnë fonde të jashtme.

#### ***Arsimi***

#### **#Rekomandimi: Përfshirja e programit të trajnimit në projektet dhe planet e veprimit në vazhdim e sipër**

Rekomandohet të mbështetet ideja e lidhjes së programit të trajnimit për ndërgjegjësim mbi barazinë me fokus të veçantë në LGBT me projektet në vazhdim e sipër mbi dhunën familjare, dhunën seksuale, dhe Drejtat e Njeriut. Prandaj kërkohet mbështetja e përgjithshme e Ministrisë së Arsimit dhe përfshirja e ndërgjegjësimit mbi barazinë dhe çështjet e lidhura me LGBT në strategjinë përkatëse për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe planin e veprimit.

#### ***Arsimi***

## **#Rekomandimi: Zgjerimi i ndërtimit të kapaciteteve lidhur me politikën miqësore të shkollës ndaj LGBT**

Në 2016, trajnerët për Barazi së bashku me mësuesit e shkollave dhe drejtorët e interesuar do të vizitojnë një shembull të praktikës së mirë të një shteti anëtarë të BE-së për të zgjeruar njohuritë dhe kapacitetet e tyre për zbatimin në mënyrë efektive politikave të një shkollë miqësore ndaj LGBT.

### **Arsimi**

#### **#Rekomandimi: Pranimi i barazisë dhe çështjeve LGBT si çështje ndërsektoriale**

Për të siguruar barazi në sistemin arsimor të Kosovës është e nevojshme pranimi i barazisë dhe çështjeve LGBT si çështje ndërsektoriale. Prandaj, rekomandohet që një përfaqësues i trajnerëve për barazi me fokus të veçantë në çështjet LGBT të ftohet në grupet përkatëse punuese (d.m.th në material arsimor / autorizimin e teksteve shkollore).

### **Për fushën e Gjyqësorit/Prokurorisë**

#### **Gjyqësori / Prokuroria**

#### **#Rekomandimi: Të ofrohet mbështetje institucionale dhe financiare për shtatë trajnime dy ditore për prokurorë dhe gjykatës në 7 regjionet e Kosovës në periudhën 2016 dhe 2017**

Ndërmjet 2016 dhe 2017, trajnerët e barazisë do të kryejnë trajnime 2 ditore në 7 regjionet e Kosovës duke forcuar kompetencat ligjore të prokurorëve dhe gjykatësve në sferën e barazisë dhe mosdiskriminimit të personave LGBT. Trajnimet duhet të organizohen në bashkëpunim me Institutin Gjyqësor të Kosovës dhe trajnerët duhet të paguhet në mënyrë adekuate për përpjekjet e tyre.

#### **Gjyqësori / Prokuroria**

#### **#Rekomandimi: Të organizohet shkëmbimi i vazhdueshëm mes kolegëve në mes Kosovës dhe MS ekspertëve të BE-së në rastet e gjykatës / prokurorisë në sferën e barazisë dhe të drejtave LGBT**

Vazhdimësia e shkëmbimit në mes kolegëve me MS ekspertët e BE-së për rastet e diskriminimit mund të nxisë përmirësimin e cilësisë së rasteve të gjykatës dhe prokurorisë brenda sistemit gjyqësor të Kosovës. Prandaj, rekomandohet që trajnerëve nga gjyqësori të ju ofrohet mundësi për t'u takuar me kolegët nga rajoni dështet anëtarë të BE-së në mënyrë që të jenë plotësisht të informuar rreth zhvillimeve të reja dhe praktikave të mira.

#### **Gjyqësori / Prokuroria**

#### **#Rekomandimi: Mbështetje rrjeteve ndërkombëtare dhe pjesëmarrjet në konferenca**

Rekomandohet të mbështetet emërimi i trajnerëve për të marrë pjesë në konferencat ndërkombëtare dhe ato evropiane dhe ngjarjet e rrjeteve, pasi pjesëmarrja fuqizon trajnerët e barazisë të gjyqësorit të Kosovës për të përfshirë standardet ndërkombëtare në sistemin gjyqësor të Kosovës.

### **Për Fushën e Policisë**

#### **Policia**

#### **#Rekomandimi: Zbatimi i barazisë & çështjeve LGBT të përfshira në trajnimin në shërbim të Policisë**

Përgjatë rregullores së brendshme nr. 21 të Organizatës së Policisë, është e obligueshme që çdo oficer i Policisë së Kosovës të kryejë një trajnim vjetor prej 40 orësh. Drejtoria për Trajnim të Specializuar dhe të Avancuar përfshinë përmbajtjen e trajnimit të barazisë me fokus të veçantë në çështjet e lidhura me LGBT në këtë trajnim të detyrueshëm, duke filluar me fillimin e trajnimit

të ri në periudhën ndërmjet korrikut 2016 dhe qershorit 2017. Rekomandohet të mbështesim këtë përpjekje.

#### ***Policia***

#### **#Rekomandimi: Zbatimi i barazisë & çështjeve LGBT të përfshira në trajnimin në shërbim të Policisë**

Përgjatë rregullores së brendshme nr. 21 të Organizatës së Policisë, është e obligueshme që çdo oficer i Policisë së Kosovës të kryejë një trajnim vjetor prej 40 orësh. Drejtorja për Trajnim të Specializuar dhe të Avancuar përfshinë përmbajtjen e trajnimit të barazisë me fokus të veçantë në çështjet e lidhura me LGBT në këtë trajnim të detyrueshëm, duke filluar me fillimin e trajnimit të ri në periudhën ndërmjet korrikut 2016 dhe qershorit 2017. Rekomandohet të mbështesim këtë përpjekje.

#### ***Policia***

#### **#Rekomandimi: Zgjerimi i grupit të trajnerëve të certifikuar**

Ndërkohë tashmë ekzistojnë 4 trajnues të certifikuar nga Policia (të trajnuar dhe certifikuar në kuadër të projektit të binjakëzimit të BE-së). Për trajnimet e mësipërme të planifikuara në shërbim, megjithatë, nevojiten më shumë trajnerë. Për këtë arsye, Drejtorja për Trajnim të Specializuar dhe Avancuar është në proces të organizimit të një seance trajnimi shtesë të trajnerëve për barazinë me fokus në çështjet e lidhura me LGBT, për të trajnuar së paku edhe 6 trajnerë më shumë (për të pasur 10 trajnues të specializuar). Rekomandohet të mbështetet ky nivel i ngritjes së kapaciteteve.

### **Për Fushën e Administratës së Përgjithshme dhe Publike**

#### ***Sektori Publik – Administrata e Përgjithshme***

#### **#Rekomandimi: Mbështetje institucionale dhe financiare për kryerjen e 2 trajnimeve njëditore për ministri në vit**

Trajnerët e barazisë nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit janë të gatshëm të vazhdojnë trajnimet për barazi me fokus të veçantë në çështjet e lidhura me LGBT. Për të siguruar 2 trajnime një-ditore për kolegë në vit dhe ministrinë, shpenzimet shtesë (për strehim, furnizim ushqimi, kostot e udhëtimit dhe tarifat e trajnerëve) kanë nevojë për alokim të buxhetit qeveritar.

#### ***Sektori Publik – Administrata e Përgjithshme***

#### **#Rekomandimi: Përfshirja e trajnimit mbi barazinë me fokus të veçantë në çështjet e lidhura me LGBT në programin e Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP)**

Për të siguruar çdo ministri dhe sektor në administratën publike, si dhe Agjencinë Statistike të Kosovës dhe Agjencinë për Barazi Gjinore me një mundësi për të ndjekur programin e trajnimit, duhet të ofrohet në kuadër të programit të rregullt të IKAP-it nga trajnuesit e certifikuar për barazinë. Kjo do të tregojë përkushtimin e administratës publike ndaj barazisë dhe çështjeve të LGBT-së dhe do të sigurojë qëndrueshmërinë për vitet e ardhshme.

#### ***Sektori Publik – Administrata e Përgjithshme***

#### **#Rekomandimi: Sigurimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional për barazinë nëpërmjet shkëmbimit ndërkombëtar**

Për të siguruar zhvillimin e vazhdueshëm profesional, trajnerët e barazisë në administratën e përgjithshme duhet të kenë mundësinë të shkëmbejnë përvojën me ekspertë ndërkombëtarë (trajnerë) në fushën e trajnimit për barazi.







